



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 87 Akti

Nr. 93 Vendimi

Tiranë, më 21.12.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Lulzim Hamitaj	Anëtar
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj.Elka Ermenkova, më datë 19 dhjetor 2018, ora 9:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z.Admir Belishta**, gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E, Ë, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (referuar më poshtë “Kushtetuta”)**

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë ligji nr. 84/2016);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit: atë pasuror, atë të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Admir Belishta, ushtron detyrën e gjyqtarit/kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, z. Admir Belishta, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 15.01.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”. Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë pasi janë caktuar me short trupat gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shpërndarë me short çështja konkrete.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 30.01.2018 u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit, z. Olsi Komici, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga asnjë prej anëtarëve të trupës gjyqësore, si dhe u vendos fillimi hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Admir Belishta. Me vendimin nr. 40, datë 16.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u vendos rishpërndarja e çështjeve të shortuara në datën 15.01.2018 me relatores znj. Alma Faskaj, për shkak të mungesës së komisioneres për një afat të pacaktuar, për arsye shëndetësore. Me shortin e hedhur në datën 16.07.2018 u caktua si relatores znj. Genta Tafa (Bungo), e cila deklaroi menjëherë mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD). Këto raporte u administruan nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. (***) prot., datë 10.01.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, pasi ka mosdeklarim të pasurisë;*
- *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. (***) prot., datë 02.11.2017 për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të këtij raporti, konstatohet përshtatshmëria e subjektit, por theksohet fakti se ky raport është hartuar në mungesë të informacionit nga një prej organeve ligjzbatuese. Pas ardhjes së këtij informacioni, me kërkesë të Komisionit nr. (***) prot., datë 01.02.2018, DSIK ka rishikuar raportin për subjektin Admir Belishta. Pas rishikimit, DSIK-ja ka dërguar raportin me shkresën nr. (***) prot., datë 07.002.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. (***) prot., datë 25.04.2018.

Në përfundim të procedurave të kryera nga grupi i punës për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Admir Belishta, me detyrë gjyqtar (Kryetar) në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Korçë, DSIK-ja konkludon në papërshtatshmëri të subjektit për vijimin e ushtrimit të detyrës.

Me shkresën nr. (***) prot., datë 29.10.2018, DSIK-ja ka rishikuar raportin për këtë subjekt, duke pasqyruar në të informacionin shtesë të ardhur nga agjensitë ligjzbatuese. Ky raport është deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. 3574, datë 30.10.2018. Në përfundim të këtij raporti rikonfirmohet papërshtatshmëria për vazhdimin e detyrës të subjektit Admir A. Belishta.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar 3 dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. (***) prot., datë 31.05.2018.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 04.12.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur

me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit, më datë 04.12.2018. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më datë 07.12.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së shpjegimeve të tij më datë 14.12.2018. Subjekti ka bërë kërkesë për pranimin e provave të reja dhe thirrjen e dëshmitarëve, kërkesë që pasi u shqyrtua nga Komisioni, u pranua pjesërisht. Ky vendim i është dërguar subjektit më datë 17.12.2018.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 17.12.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 19.12.2018, ora 09:00, në adresën: Pallati i Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Admir Belishta, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

V. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- f) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur.

Në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 30.01.2017, **subjekti deklaron këto pasuri** (të paluajtshme dhe të luajtshme) në emër të tij:

1. Shtëpi banimi e llojit apartament me sip.107 m², në zk. (***), me nr. pas (***) me adresë në Korçë, blerë me kontratën e shitjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 22.09.2009. Burimi i krijimit: Nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Vlera e kësaj pasurie: Shuma e shpenzuar për blerje dhe mobilim, gjithsej 6,000,000 lekë. Pjesa takuese: 100%

Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Certifikatë pronësie, datë 21.01.2017 e lëshuar në emër të Admir Belishta për apartamentin me sipërfaqe totale 107 m², zk. (***), nr. pas. (***), vol. (***), fq. (***);
- Kartelë pasurie për apartamentin me sip.107 m²;
- Kontratë shitje apartamenti me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 22.09.2009 me shitës T. C. dhe blerës Admir Belishta për apartamentin me sipërfaqje 107 m² në Rr. “(***),” p.1, sh.1, ap.4, kati 3. Çmimi i shitjes 4,900,000 lekë, likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale;
- Vërtetim nga ZVRPP-ja Korçë për korrigjimin e gabimeve të gjendura në certifikatën e pronësisë në rubrikën “vol” dhe “faqe” pasi ato kishin gabime materiale.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë nr. (***) prot., datë 02.02.2018 drejtuar ZVRPP-së Korçë. ZVRPP-ja Korçë me shkresën nr. (***)prot., datë12.02.2018 ka konfirmuar se në emër të Admir Belishta rezulton e regjistruar pasuria apartament, me sipërfaqe 107 m², me nr. pas. (***), vol. (***), fq. (***), zk. (***), duke bashkëngjitur dhe kontratën e shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 22.09.2009 me shitës T. C. dhe blerës Admir Belishta me çmimin 4,900,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Shkresë nr. (***) prot., datë 02.02.2018 drejtuar OSHEE-së, ku kërkohet informacion në lidhje me subjektin dhe personat e lidhur me të. Me shkresën nr. (***) prot., datë 20.01.2018, OSHEE-ja konfirmon kontratën e lidhur me subjektin Admir Belishta për adresën ku ndodhet apartamenti në Rr. “(***).”
- Shkresë nr. (***)prot., datë 05.03.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku është kërkuar informacion për proceset gjyqësore që mund të ketë pasur huadhënësi në këtë gjykatë dhe me cilin gjyqtar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me shkresën nr. (***) Prot., datë 09.03.2018 ka vënë në dispozicion një vendim gjykate për një çështje me paditës huadhënësin, gjykuar nga gjyqtarja S. V.

➤ Shkresë nr. (***) prot., datë 08.03.2018 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar informacion në lidhje me veprimet noteriale të kryera në zyrat noteriale për subjektin A. Belishta dhe familjarët e tij.

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. (***) prot., datë 19.03.2018 ka vënë në dispozicion listën me veprimet noteriale të kryera në zyrat noteriale nga ana e subjektit dhe familjarëve të tij.

➤ Shkresë nr. (***) prot., datë 05.10.2018 drejtuar bankave të nivelit të dytë për aftësitë financiare të M. Z.

➤ Shkresë nr. (***) prot., datë 05.10.2018, drejtuar ZVRPP-së Korçë për pasuritë e M. Z.

Arsyetimi ligjor:

Subjekti ka deklaruar pronësinë mbi një apartament me sipërfaqe 107 m², ndodhur në Korçë. Ky fakt vërtetohet edhe nga dokumentacioni i dërguar nga ZVRPP-ja Korçë.

Në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për këtë pasuri, detyrim ky i parashikuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës.

Nga shqyrtimi i deklaratave të pasurisë ndër vite, rezulton se në vitin 2009 subjekti ka deklaruar: “shtesa si rezultat i blerjes së një apartamenti me sip. 107 m², ndodhur në Korçë, çmimi i blerjes 4, 900, 000 lekë”, si dhe “pakësim i të gjitha kursimeve të krijuara deri tani, si rezultat i blerjes së apartamentit, i mobilimit të tij dhe i shlyerjes së një pjese të huas së marrë në shumën 4, 668, 860 lekë.”

Në deklaratën “Vetting”, për të njëjtën pasuri, subjekti deklaroi si vlerë të shpenzuar për blerjen dhe mobilimin e këtij apartamenti shumën prej 6, 000, 000 lekë.

Në lidhje me këtë pasuri, subjektit iu dërgua pyetësori nr. 2, datë 03.09.2018, në të cilin i janë kërkuar specifikime për sa i përket burimit të krijimit si dhe dokumentacion justifikues, që vërteton pagimin e çmimit prej 4, 900, 000 lekë shitësit.

Subjekti në përgjigjen e tij ka deklaruar:

a) Burimi i të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti janë:

- kursimet e mbledhura në vite nga paga, honoraret nga mësimdhënia, botimet;
- pjesëmarrja në mbledhjet e bordit të buxhetit gjyqësor;
- shitja e makinës;
- të ardhura si rezultat i ndarjes nga familja;
- një pjesë nga huaja;

Ai thekson faktin që gjatë kësaj periudhe ka qenë beqar, duke qenë konsumator vetëm për një person.

b) Në lidhje me dokumentacionin justifikues që vërteton pagimin e çmimit në favor të shitësit, subjekti ka deklaruar se pagesa e shumës për blerjen e apartamentit është dhënë *cash*, ashtu siç referohet në kontratë.

Në lidhje me mobilimin e këtij apartamenti, pasi është pyetur, subjekti ka deklaruar se: *“Nga shuma 6,000,000 lekë deklaruar në deklaratën “Vetting” si vlerë blerje apartamenti dhe mobilimi të tij, për mobilimin janë përdorur 1,100,000 lekë. Fatura të mobilimit të saj nuk disponoj.”*

Referuar deklaratës “Vetting” 2017 subjekti ka deklaruar vlerën 6,000,000 lekë për “blerje dhe mobilim”, ndërkohë që në deklaratën periodike të vitit 2009 ka deklaruar vlerën 4,900,000 lekë si pakësim i të gjithë kursimeve për blerje dhe mobilim të apartamentit.

- ☛ Nga krahasimi i deklarimeve të subjektit, bazuar në pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni konstatoi mospërputhje ndërmjet deklaramit të pasurisë në vitin 2009 me deklaratën “Vetting” në lidhje me çmimin e blerjes plus shpenzime mobilimi për këtë apartament, në shumën prej 1,100,000 lekë.

Nisur nga deklaramet e subjektit ndër vite, deklarata “Vetting”, si dhe sqarimet e dhëna para Komisionit, u krye analiza financiare:

Përshkrimi	01.01.2009- 22.09.2009
Të ardhurat	653,508
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti për periudhën 01.01.2009-01.09.2009	653,508
Likuiditete	3,560,000
Kursime CASH deri më 01.01.2009	3,560,000
Shpenzime	1,339,346
Shpenzime jetese sipas ILDKPI-së për periudhën 01.01.2009-22.09.2009	139,212
Shpenzime për mobilim shtëpie	1,100,000
Shpenzime udhëtimi deri më 22.09.2009	100,134
Pasuri	4,900,000
Apartament banimi me sip.107 m ² në Korçë	4,900,000
Detyrime	1,000,000
Hua nga shtetasi M. Z. marrë me 12.09.2009	1,000,000
Të ardhura +likuiditete + detyrime - shpenzime – pasuri	-1,025,838

Në përfundim të analizës financiare ka rezultuar se subjekti ka patur mungesë të të ardhurave të ligjshme në masën **-1,025,838** lekë për blerjen e këtij apartamenti më datë 22.09.2009 (sipas kontratës së shitblerjes).

Si burim për blerjen dhe mobilimin e këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit të Komisionit edhe një hua të marrë në shumën prej 1,000,000 lekë nga shtetasi M. Z. me afat 2-vjeçar pa interes (shlyer 400,000 lekë, mbetur 600,000 lekë). Këtë burim të ardhurash, subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, meqënëse e ka shlyer në vitin 2010.

Në përgjigje të pyetësorit, më datë 03.09.2018, subjekti ka deklaruar se M. Z. është kushëri i parë i babait (djali i hallës). Ai ka bashkëlidhur edhe kontratën e huasë me nr(***)rep., nr. (***) kol., datë 12.09.2009. Subjekti deklaron se arsyeja e marrjes së kësaj huaje ka qenë kryesisht për shkaqe mobilimi të shtëpisë. Sipas këtij deklarimi pagesa është kryer *cash* dhe nuk disponon dokumentacion provues të pagimit të shumave, as në huamarrje dhe as në kthimin e kësaj huaje.

Komisioni ka hetuar në lidhje me aftësitë huadhënëse të z. M. Z. Nga ky hetim rezulton se huadhënësi i kishte mundësitë financiare për këtë hua.

Po në vitin 2009, subjekti, në deklarimin e pasurisë, ka deklaruar shlyerjen e një pjese të kësaj huaje prej 400, 000 lekë.

Nga analiza financiare e kryer për pjesën e fundit të viti 2009, pra pas blerjes së apartamentit, ka rezultuar:

Përshkrimi	23.09.2009- 31.12.2009
Të ardhurat	326,754
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti për periudhën 01.09.2009-31.12.2009	326,754
Shpenzime	452,071
Shpenzime jetese sipas ILDKPI-së për periudhën 23.09.2009-31.12.2009	52,071
Shlyer detyrimi ndaj shtetasit M. Z. për vitin 2009	400,000
Likuiditete	600,000
Gjendje likuiditetesh CASH më 31.12.2009	600,000
Të ardhura - shpenzime – gjendje likuiditetesh në fund të periudhës	-725, 317

Në këtë analizë janë marrë parasysh deklaratimet e subjektit në vitin 2009, si shtesa si rezultat i kursimeve nga paga si kryetar gjykate gjatë një viti kalendarik (vlera neto vjetore, gjendje cash) shuma prej 600, 000 lekë, si dhe deklarimi për shlyerjen e një pjese të huas në shumën 400, 000 lekë.

Në përfundim konstatohet se në fund të kësaj periudhe, subjekti rezulton me mangësi të theksuara financiare, pas shlyerjes së një pjese të huas, në shumën - **725,317** lekë.

Nga hetimi administrativ rezulton se subjekti nuk e ka marrë këtë hua në kushtet e konfliktit të interesit.

Në përputhje me nenin 52 të ligjit 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me :

- ⊗ Mosdeklarimin e burimit të krijimit të apartamentit 107 m² në Korçë, në deklaratën “Vetting”, sipas detyrimit kushtetues;
- ⊗ Mospërputhjen e deklarimit të vlerës së blerjes së apartamentit dhe mobilimit të tij midis deklarimit në vitin 2009 dhe atij “Vetting”.
- ⊗ Mungesë të ardhurash për blerjen e këtij apartamenti në shumën prej **-1,025,838** lekë.
- ⊗ Mungesë e theksuar të ardhurash për vitin 2009 në shumën **-1 751 331** lekë.

Në parashtrimet e tij, si dhe në seancë dëgjimore, zoti Belishta ka dhënë shpjegime.

Pasi shqyrtoi provat dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se:

- Megjithëse subjekti i rivlerësimit nuk solli dokument ligjor justifikues lidhur me shumën prej 1,400,000 lekë e trashëguar nga familja pas ndarjes nga trangu familjar, kjo shumë u mor në konsideratë në analizën financiare, për shkak të shpjegimeve të tij që u konsideruan bindëse.
- Për sa i takon kursimeve të akumuluarra deri në vitin 2009 dhe pasi Komisioni shqyrtoi pretendimin e subjektit lidhur me këto kursime, rezultoi se në deklaratat periodike për periudhën 2005-2008 subjekti ka deklaruar shpenzime qiraje në shumën 60,000 lekë në vit. Në deklaratimet periodike të këtyre viteve është deklaruar se ky shpenzim është mbuluar nga kursimet e subjektit dhe për të gjitha këto vite është zbritur nga kursimet vlera e qirasë vjetore.
- Në vitin 2008 kursimet vjetore janë në shumën 1,090,000 lekë, ndërsa në fund të vitit 2007 subjekti kishte 2,470,000 lekë kursime *cash* të deklaruara. Në total, në fund të vitit 2008, gjendja e kursimeve *cash* është 3,560,000 lekë. Huaja prej 1,000,000 lekë e marrë në vitin 2009 është shlyer pjesërisht, po në vitin 2009, në shumën 400,000 lekë dhe nëse shumës së kursimeve *cash* të deklaruara nga subjekti në fund të vitit 2008 do t'i shtohet dhe shuma e kredisë që dispononte subjekti, duke konsideruar dhe shlyerjen prej 400,000 lekë në vitin 2009 si dhe shpenzimet e jetesës dhe shpenzimet e tjera të kryera nga subjekti deri në momentin e blerjes së apartamentit, nuk mund të justifikohet shuma për blerjen e apartamentit. Subjekti gjithashtu ka deklaruar se *“vlera e shpenzimeve të mia për këto vite është më e madhe se standardi i kalkuluar nga ILDKPKI –ja”*.
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 subjekti ka deklaruar kursime *cash* në shumën 600,000 lekë dhe gjendja e kursimeve *cash* të deklaruara është gjendja e kursimeve në datën 31.12.2009. Deklaratat periodike vjetore shërbejnë si provë, për pasojë, Komisioni mori në konsideratë këtë gjendje likuiditetesh në fund të vitit 2009.
- Për vlerën e mobilimit, Komisioni vlerësoi të marrë në konsideratë pretendimin e subjektit lidhur me shpërndarjen e shpenzimit të vlerës së mobilimit në shumën prej 1,100,000 lekë për periudhën 2009-2014, duke mos e trajtuar si shpenzim të kryer të gjithin në vitin 2009.

Kursimet *cash* të marra në konsideratë nga Komisioni në analizën financiare janë si më poshtë:

Nr.	Vitet	Kursime sipas viteve në lekë
1	2003	1,500,000
2	2004	1,400,000
3	2005	240,000
4	2006	340,000
5	2007	490,000
6	2008	1,090,000
7	2009	600,000
8	2010	581,941

9	2011	1,334,464
10	2012	529,096
11	2013	111,038
12	2014	Pakësim të kursimeve në shumën 1,819,744
13	2015	449,928
14	2016	250,000

Pas shpjegimeve të subjektit që Komisioni mori në konsideratë për vitin 2009, analiza financiare e vitit 2009 është si më poshtë:

Përshkrimi	Viti 2009
Të ardhurat	980,262
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti	980,262
Shpenzime	871,417
Shpenzime jetese sipas ILDKPI	191,283
Shpenzime për mobilim shtëpie	180,000
Shlyer detyrimi ndaj shtetasit M. Z. për vitin 2009	400,000
Shpenzime udhëtimi	100,134
Detyrime	1,000,000
Hua nga shtetasi M. Z. marrë me 12.09.2009	1,000,000
Likuiditete	-2,959,824
Kursime CASH + bankë në fillim të periudhës	3,559,990
Kursime CASH + bankë në fund të periudhës	600,165
Pasuri	4,900,000
Apartament banimi me sip.107 m ² në Korçë	4,900,000
Të ardhura- shpenzime + detyrime – likuiditete - pasuri	-831,331

Në përfundim konstatohet se:

- Subjekti nuk ka deklaruar burimin e kësaj pasurie, në kundërshtim me detyrimin kushtetues;
- Në fund të kësaj periudhe, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurisë apartament si dhe për të mbuluar shpenzimet e kryera përgjatë vitit 2009, në vlerën 831,331 lekë.

1. **Shtëpi e ndodhur në fshatin e lindjes në B., Bashkia Maliq**, mbi pronën e përfituar si anëtar i familjes bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme 470 m² dhe sipërfaqe bazike ndërtimi 62.4 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 130.03 m², legalizuar me leje legalizimi nr. (***) , datë 26.12.2014 e regjistruar në ZVRPP-në Korçë me nr. pas (***) , zk. (***) . Burimi i krijimit: Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit sipas detyrimit kushtetues.
Vlera: 2,600,000 lekë (shuma e shpenzuar për ndërtim dhe mobilim)
Pjesa takuese: 100%

Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Leje legalizimi nr(***), datë 26.12.2014 në emër të Admir Belishta për objektin godinë banimi 2 kate me sipërfaqje ndërtimi 62.4 m² dhe sipërfaqje totale ndërtimi 130.03 m².
- Certifikatë pronësie në emër të Admir Belishta për truallin me sipërfaqje 470 m², datë 24.10.2016;
- Hartë treguese e regjistrimit (fragment);
- Kartelë pasurise për 470 m² truall dhe 62.40 m² ndërtesë.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. (***) prot., datë 02.02.2018 drejtuar ZVRPP-së Korçë ku kërkohet informacion në lidhje me pasuritë e paluajtshme në emër të subjektit Admir Belishta dhe familjarëve të tij.

ZVRPP-ja Korçë me shkresën nr. (***) prot., datë 12.02.2018 ka konfirmuar se Admir A. Belishta ka të regjistruar pasurinë nr. (***), vol. (***), fq. (***), zk (***), truall me sipërfaqje 470 m² nga të cilat ndërtim 62.4 m², regjistruar në bazë të lejes së legalizimit nr. (***), datë 26.12.2014.

- Shkresë nr. (***)prot., datë 02.02.2018 drejtuar ALUIZNI-t Korçë ku i është kërkuar e gjithë dosja e plotë e praktikës së legalizimit.

ALUIZNI Korçë me shkresën nr. (***)prot., datë 30.03.2018, ka vënë në dispozicion të gjithë dosjen e legalizimit (formular vetëdeklarimi, aktkualifikimi, skica, genplan, shkresa të tjera, leje legalizimi) për subjektin A. Belishta në lidhje me shtëpinë në B., Korçë. Gjithashtu në këtë dosje, ALUIZNI ka depozituar dhe foto të kësaj shtëpie të ndërtuar në fshatin B., Korçë.

- Shkresë nr. (***)prot., datë 05.03.2018 drejtuar ZVRPP-së Korçë, në të cilën kërkohen të dhëna dhe shpjegime shtesë, në lidhje me bashkimin e pasurive.

ZVRPP-ja Korçë me shkresën nr. (***)prot., datë 15.03.2018 ka konfirmuar se në bazë të kërkesës së vetë subjektit A. Belishta, është bërë bashkimi i këtyre dy pasurive në një të vetme në 470 m², duke vendosur bashkëlidhur kësaj shkrese listën e printimit të III.

- Shkresë nr. (***) prot., datë 18.04.2018 drejtuar ZVRPP-së Korçë, ku është kërkuar informacion në lidhje me mënyrën e përfitimit të pronës nga A. B. (i ati i subjektit).

ZVRPP-ja Korçë me shkresën nr. (***)prot., datë 02.05.2018 ka dërguar informacionin e kërkuar në lidhje me pasuritë e A. B.

- Shkresë nr. (***) prot., datë 02.02.2018 është drejtuar ALUIZNI-t Korçë, ku i është kërkuar e gjithë dosja e plotë e praktikës së legalizimit.

ALUIZNI Korçë me shkresën (***)prot., datë 30.03.2018 ka përcjellë informacionin e kërkuar.

- Shkresë nr. (***) prot., datë 05.03.2018 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku kërkohen vendime gjyqësore për çështjet me objekt “ndërtim pa leje”, gjyqtarin që e ka gjykuar si dhe mënyrën e përfundimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me shkresën nr. (***) prot., datë 09.03.2018 ka vënë në dispozicion një listë me çështje gjyqësore sipas kërkesës.

- Shkresë nr. (***)prot., datë 15.03.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ku kërkohen disa vendime të gjykuara nga subjekti Admir Belishta.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me shkresën nr. (***) prot., datë 19.03.2018 ka dërguar pranë Komisionit vendimet gjyqësore të kërkuara.

- Shkresë nr. (***) prot, datë 18.04.2018 drejtuar ZVRPP-së Korçë, në të cilën kërkohen informacione shtesë për truallin e përfituar nga AMTP-ja.

ZVRPP-ja Korçë me shkresën nr. (***) prot., datë 02.05.2018, ka dhënë sqarimet dhe informacionin e nevojshëm.

- Shkresë nr. (***) prot, datë 19.09.2018 drejtuar ZVRPP-së Korçë në të cilën kërkohen informacione shtesë për AMTP-në si dhe për truallin 470 m².

ZVRPP-ja Korçë me shkresën nr(***)prot., datë 26.09.2018, ka dhënë sqarimet dhe informacionin e nevojshëm.

- Shkresë nr. (***) prot., datë 30.08.2018 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është kërkuar informacion me çështjet gjyqësore që ka pasur shtetasi P. K. (kryetari i Komunës L.) në këtë gjykatë dhe me cilin gjyqtar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me shkresën nr. (***) prot., datë 04.09.2018 ka dërguar dy vendime për dy çështje që ka pasur P. K., por që nuk janë gjykuar nga subjekti Admir Belishta.

Arsyetimi ligjor:

A. Admir Belishta sipas deklaratës “Vetting” ka në pronësi shtëpi, të ndodhur në fshatin e lindjes, B., Bashkia Maliq, ndërtuar mbi pronën e përfituar si anëtar i familjes bujqësore me sipërfaqe të përgjithshme 470 m², sipërfaqje bazike ndërtimi 62.4 m² dhe sipërfaqje totale ndërtimi 130.03 m², legalizuar me leje legalizimi nr(***), datë 26.12.2014, e regjistruar në ZVRPP-në Korçë me nr.pas (***), zk. (***)

Si anëtar i familjes bujqësore, subjekti pretendon se ka përfituar nga ligji nr. 7501 sipërfaqen 2970 m², së bashku me truallin ku është ndërtuar shtëpia.

Kjo pasuri është rezultat i kontratës së pjesëtimit vullnetar nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 13.11.2014, sipas së cilës pasuria prej 820 m² truall + ndërtesë në bashkëpronësi të A., M., Admir dhe B. B. pjesëtohet respektivisht në 350 m² nga ku ndërtesa 78 m² në emër të A., M. dhe B. B., ndërsa z. Admir Belishta i mbetet pjesa prej 470 m².

Më pas kjo pasuri, me kërkesë të subjektit, është ndarë në dy pasuri më vete: pasuria nr. (***) e llojit truall me sipërfaqje 125 m², nga të cilat ndërtesë 62.4 m² dhe pasuria nr. (***) me sipërfaqje 345 m². Më pas kjo pasuri është bashkuar përsëri në një të vetme.

Në lidhje me këtë fakt, Komisioni kërkoi informacion nga ZVRPP-ja Korçë.

Kjo zyrë ka konfirmuar se në bazë të kërkesës së vetë subjektit A. Belishta, është bërë bashkimi i këtyre dy pasurive në një të vetme në 470 m².

Sipas AMTP-së, pa datë, me nr. (***), ndër sipërfaqet e tjera të tokës, rezulton që në rreshtin e parë të renditjes përshkruhet gjithsej 300 m² nga ku 50 m² arë dhe 250 m² truall. Po bashkëngjitur kësaj shkrese është dhe lista e printimit të III nga ku ka rezultuar se për këtë sipërfaqje kemi të dhënat: vol. (***), fq. (***) truall+arë, sipërfaqja sipas tapisë 300 m² dhe sipërfaqja sipas matjeve është 750 m².

Pra, nga 300 m² në fillim të dhënies së AMTP-së, pas matjeve të kryera, ka rezultuar sipërfaqja 750 m².

Referuar vendimit të Komunës L. nr. 3, datë 08.09.2014 me objekt “Kalimin në pronësi të pasurisë nr. (***), zk. (***), shtëpi banimi e ndodhur në B.” rezulton me sipërfaqe të përgjithshme 820 m² nga të cilat sipërfaqe ndërtesë 78 m². Sipas këtij vendimi kjo pasuri është regjistruar me sipërfaqe 750 m², kur në fakt në terren rezulton të jetë 820 m² sipas planit të rilevimit dhe në bazë të VKM nr. 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më datë 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”.

Pra, në lidhje me këtë pasuri rezultojnë të jenë bërë 3 matje, e para në vitet '90 sipas AMTP-së 300 m² (arë+truall), më pas sipas ZVRPP-së Korçë, kur është bërë regjistrimi pas matjeve ka rezultuar 750 m² dhe më pas, sipas vendimit nr. 3 të Komunës L. pas matjes ka rezultuar sipërfaqja 820 m².

Duke konstatuar një ndryshim të herëpashershëm të sipërfaqes në pronësi të babait të subjektit, Komisioni i kërkoi shpjegime ZVRPP-së Korçë.

ZVRPP-ja Korçë ka shpjeguar mënyrën e përfitimit të truallit nga A. B. sipas AMTP-së, duke iu referuar akteve ligjore respektive.

Sipas ZVRPP-së Korçë: “Regjistrimi i parë për këtë pasuri në bazë të rrjeshtit të parë AMTP-së nr. (***) dhe librit të ngastrave nuk është quajtur i rregullt nga ana jonë, sepse në bazë të ligjit nr.7501 me akte të marrjes së tokës në pronësi nuk mund të trajtoheshin tokë truall dhe ndërtesa. Pasqyrimi i truallit në rrjeshtin e parë të aktit të marrjes së tokës në pronësi është kryer gabim nga komisioni i ndarjes së tokës në pronësi.”

Për pasuritë e regjistruara 300 m² dhe 750 m², nuk është proceduar me certifikata pronësie, ndërsa pasuria e llojit truall me sip.820 m², nga të cilat ndërtesë 78 m², është regjistruar dhe është lëshuar certifikatë pronësie vetëm në bazë të vendimit të Komunës L. nr.3, datë 08.09.2014, procedurë kjo e bazuar në VKM-në nr. 608, datë 05.09.2012.

Në lidhje me gjithë këtë situatë, subjekti ka sqaruar në përgjigje të pyetësorit se, mënyra e përfitimit të kësaj pasurie shpjegohet nga dokumentacioni që ka vendosur bashkëngjitur, si dhe nga rruga ligjore e ndjekur. Edhe për arsyen e ndarjes së pronës në dy parcela dhe më

pas bashkimit e saj në një të vetme, subjekti e arsyeton si një ndarje ligjore e detyruar dhe vendimarrje e organeve që kanë disponuar me legalizimet dhe regjistrimet.

Në lidhje me pyetjen tonë se përse rezultojnë 3 matje me sipërfaqje të ndryshme për sa i përket sipërfaqjes së truallit të përfituar nga babai i tij, subjekti ka deklaruar se këto rregullime janë bërë nga organet ligjzbatuese sipas vendimarrjes ligjore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe krahasimi i të dhënave, rezulton se babai i subjektit, z. A. B., ka depozituar pranë Komunës L. kërkesën e tij për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme me nr. (***) , bazuar në VKM-në nr. 608/2012. Kryetari i Komunës L., zoti P. K., bazuar në këtë kërkesë, ka vendosur kalimin në pronësi të kësaj pasurie me sipërfaqe totale 820 m², nga të cilat 78 m² ndërtesë në favor të A. B. Referuar analizës ligjore të fakteve në këtë vendim të Komunës L. , konstatohet se: “Ndërtesa është bërë para vitit 1991, gjë që provohet nga vërtetimi i lëshuar nga organi i pushtetit vendor (dhe bëhet fjalë për vërtetimin e datës 30.09.2014 të Komunës L., të nënshkruar po nga kryetari i saj zoti P. K.) dhe nga verifikimi në vend i kryer nga ana e specialistëve të komunës konstatohet se nuk janë bërë shtesa ose ndryshime në strukturën e ndërtesës.”

Në germën “b”, të pikës 4, të VKM-së nr. 608/2012, parashikohet se trualli funksional duhet të rezultojë fizikisht i lirë dhe i pazënë nga ndërtime pa leje, të cilat janë objekt i ligjit nr. 9482/2006.

Nga dokumentacioni i përcjellë nga ALUIZNI, konstatohet se subjekti ka vetëdeklaruar ndërtimin e shtëpisë dykatëshe mbi truallin prej 420 m², të ndërtuar në vitin 2013. Kjo vërtetohet edhe nga fotografimi i bërë më datë 20.08.2013, fotografi që gjenden në dosjen e ALUIZNI-t.

Nga analiza e dokumentacionit konstatohet gjithashtu se vendimi nr. 3, datë 08.09.2014 i Komunës L. është përcjellë pranë ZVRPP-së Korçë më datë 23.10.2014, duke pretenduar se ka qëndruar i afishuar për 45 ditë, sipas parashikimit ligjor.

Ndërkohë, po në këtë dosje figuron procesverbali i datës 24.10.2014, nënshkruar po nga P. K., ku theksohet se: “Vendimi nr. 3, datë 08.09.2014 i Komunës L. u afishua dhe në përfundim të afatit 45-ditor të afishimit nuk kishte asnjë kundërshtim për këtë pasuri.” Edhe në planin e rievimit bashkëlidhur dokumentacionit përkatës rezulton data e përgatitjes 01.09.2014. Në këtë plan rievimi ku duhet të pasqyrohej gjendja faktike e pronës, rezulton vetëm njolla e shtëpisë së vjetër dhe jo shtëpia dykatëshe e subjektit dhe e deklaruar prej tij.

- Nga sa më sipër rezulton se mënyra e përfitimit të pronësisë së truallit prej 820 m² nga A. B. nuk është kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi. Babai i subjektit ka përfituar këtë sipërfaqe toke në kundërshtim me kriteret e parashikuara në VKM-në nr. 608/2012. Prej këtij trualli, 470 m² i ka përfituar vetë subjekti, i cili nuk arrin të provojë ligjshmërinë e burimit, duke cenuar figurën e gjyqtarit.

Komisioni hetoi në lidhje me vendime gjyqësore të dhëna nga subjekti në favor të kryetarit të Komunës L. Nga ky hetim rezultoi se P. K. ka patur disa çështje gjyqësore të shqyrtuara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, por që nuk janë gjykuar nga subjekti.

Nga faktet e renditura më sipër mund të lindin dyshime për ndikimin e subjektit tek gjyqtarët që kanë dhënë vendime në favor të shtetasit P. K., por Komisioni nuk arriti ta provojë një gjë të tillë në kuadrin e hetimit administrativ.

Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar se shtëpia në fshatin e lindjes B. është ndërtuar mbi pronën e përfitur si anëtar i familjes bujqësore. Nga hetimi administrativ, si dhe nga dokumentacioni i depozituar nga ZVRPP-ja Korçë dhe vetë subjekti, rezulton se ky truall është përfitur nga subjekti me anë të vendimit të Komunës L. nr. 3, datë 08.09.2014 me objekt “Kalimin në pronësi të pasurisë nr. (***) , zk. (***) , shtëpi banimi e ndodhur në B. me sipërfaqe të përgjithshme 820 m² nga të cilat sipërfaqe ndërtese 78 m²” dhe jo nga ligji nr. 7501.

- ☛ Në këto kushte subjekti ka kryer deklarim të rremë në lidhje me mënyrën e përfitimit të truallit prej 470 m², ku ka ndërtuar shtëpinë.

B. Mbi këtë truall subjekti ka në pronësi shtëpi me sipërfaqe të përgjithshme 470 m² dhe sipërfaqe bazike ndërtimi 62.4 m², si dhe sipërfaqe totale ndërtimi 130.03 m², legalizuar me leje legalizimi nr(***) , datë 26.12.2014 e regjistruar në ZVRPP-në Korçë me nr.pas (***) , zk. (***) .

Për herë të parë subjekti e ka deklaruar këtë shtëpi në deklaratën periodike të 2014.

Nga dokumentacioni në dosje rezulton e depozituar deklarata për përfshirje në procedurën e legalizimit të ndërtimit pa leje, deklarues Admir Belishta më datë 17.11.2014 ku deklarohet: “*Deklaroj se ndërtimi është ngritur në 2013 në fshatin B.*”.

Meqënëse shtëpia është deklaruar në vitin 2014, ndërsa ndërtimi është bërë më parë (sipas vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t në vitin 2013), është pyetur subjekti. Atij i është kërkuar të vërë në dispozicion dokumentacionin respektiv, si: preventiva, situacione, fatura, pagesa për të provuar shumën e shpenzuar të deklaruar, si dhe emrin e shoqërisë apo shoqërive që ka ndërtuar apo ka bërë punime të ndryshme në shtëpinë në B. si dhe të specifikojë sa ka qenë vlera e shpenzuar për mobilimin e kësaj shtëpie si dhe burimin e të ardhurave me të cilët është bërë ky mobilim.

Subjekti në përgjigjen e tij të datës 03.09.2018 ka deklaruar se ndërtimi ka përfunduar si i tillë në fund të vitit 2013, duke përjashtuar disa punime të brendshme druri që kanë vazhduar në vitin 2014 dhe se kjo ka qenë arsyeja që deklarimi është bërë në 2014. Subjekti ka pretenduar se paraprakisht u është drejtuar organeve vendore, që konform rregullave, ta pajisnin me leje ndërtimi, po për shkak të bllokimit të lejeve, nuk u bë e mundur një gjë e tillë. Në lidhje me dokumentimin e shpenzimeve, subjekti ka pretenduar se nuk ka, pasi nuk është bërë ndonjë projekt i mirëfilltë inxhinierik, por nga vetë kërkesat e tij që janë zbatuar nga punëtorët.

Subjekti ka bashkëngjitur fatura të blerjes së materialeve drusore dhe punimeve të kryera, me të cilat është pajisur nga disa subjekte tregtare, ndërsa për gurët, subjekti pretendon se nuk ka pasur kosto shtesë, pasi janë marrë nga një shtëpi e vjetër e rrënuar dhe nuk është suvatuar as nga jashtë, dhe as nga brenda.

Komisioni analizoi faktin e ndërtimit pa leje nga subjekti në vitin 2013 dhe deklarimin si të tillë në vitin 2014.

Fakti i ndërtimit të shtëpisë në vitin 2013 dhe deklaruar në vitin 2014, duhet parë në kontekstin juridik të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Në ndryshimin e bërë në vitin 2013, ligji përcakton se: “...ky ligj mund të zbatohet për objektet e ndërtuara pa leje, të ngritura pas hyrjes në fuqi të ligjit, vetëm në rast se për to procedura e legalizimit nuk kërkon kalim pronësie mbi truallin”.

Pra, sipas këtij ndryshimi të ligjit, çdo ndërtim pa leje që është kryer pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.141/2013, do të legalizohet vetëm për ato raste kur procedura e legalizimit nuk kërkon kalim pronësie mbi truallin.

Rezulton që formulari i vetëdeklarimit të ndërtimit pa leje është dorëzuar më datë 17.11.2014, të nënshkruar nga vetë subjekti A. Belishta, ku ai ka deklaruar se kërkon që të bëhet pjesë e procesit të legalizimit të ndërtimit pa leje. Subjekti ka deklaruar në këtë formular se ndërtimi është ngritur në vitin 2013, duke vazhduar deklarimin që trualli mbi të cilin ngrihet ndërtimi pa leje është pasuri e subjektit me dokumentacion ligjor.

Subjekti në këtë dosje ka depozituar certifikatën e pronësisë mbi truallin 470 m², lëshuar kjo me datë 13.11.2014 në emër të Admir Belishta. Më pas është vijuar me lëshimin e lejes së legalizimit nr. (***) , datë 26.12.2014.

Pra, duket mjaft qartë që subjekti qëllimisht nuk e ka deklarur ndërtimin pa leje në vitin 2013, pasi në atë kohë ai ende nuk kishte titullin e pronësisë për truallin ku kishte bërë ndërtimin pa leje, dhe në këtë mënyrë nuk mund ta legalizonte ndërtesën e tij.

Me veprime të përsheptuara ai arriti që të fitojë pronësinë mbi tokën fillimisht dhe më pas vijoi procesin e legalizimit, ashtu siç duket dhe mjaft qartë dhe nga datat e kryerjes së veprimeve respektive. Pra, e gjithë procedura e regjistrimit të truallit në ZVRPP dhe lëshimit të lejes së legalizimit për ndërtesën mbi këtë truall si dhe regjistrimin e saj, bërë brenda një harku kohor shumë të shkurtër rreth 1 muaji e gjysmë, me qëllim përfitimin sipas ligjit nr. 141/2013.

Referuar vetëdeklarimit të subjektit, ndërtimi i kësaj shtëpie është bërë pa leje, në vitin 2013.

Komisioni konstaton se ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar në nenin 3 “Përkufizime” citon: “Ndërtim pa leje, është objekti për të cilin është përfunduar karabinaja, i destinuar ...” Pra, që në këtë fazë (të karabinasë) ai konsiderohej si ndërtim pa leje (që duhej të deklarohet që në fazë karabinaje), por ai është deklaruar si i tillë vetëm në vitin 2014, kur është ndërtuar (referuar formularit të dorëzuar nga vetë subjekti pranë ALUIZNI-t, në të cilin e deklaroi si ndërtim të bërë në vitin 2013). Referuar ndryshimeve të Kodit Penal, në vitin 2008, me ligjin nr. 10 023, ndërtimi pa leje konsiderohet si ndërtim i paligjshëm.

Për sa analizuam më sipër, subjekti, me kryerjen e këtij ndërtimi në tokën e tij, i papajisur me lejen përkatëse të ndërtimit, duket sikur ka konsumuar elementët e veprës penale të “ndërtimit të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a-1 i Kodit Penal, pasi nga ky veprim janë cenuar marrëdhëniet juridike që mbrojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve në përputhje me ligjin dhe rregulloren e zhvillimit të territorit.

Pika 1 e nenit 4 të ligjit 9/2016 përcakton se magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare.

Komisioni ka hetuar edhe në lidhje me proceset me objekt gjyqësor ndërtimin e paligjshëm, të shqyrtuara nga subjekti. Për këtë janë kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, të gjitha vendimet me këtë objekt, të gjykuara nga ky gjyqtar, për periudhën 2014-2016. Në të gjithë vendimet e tij si gjyqtar, subjekti Admir Belishta ka vendosur dënimin me gjobë/ burgim ndaj shtetasve, që kanë konsumuar elementët e veprës penale të ndërtimit pa leje, sipas vendimeve respektive.

Në këto vendime subjekti ka përdorur këto argumente ligjorë në lidhje me veprën penale “të ndërtimit të paligjshëm” si vijon:

“Konsumi i kësaj vepre penale nga të pandehurit, ka cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura në territorin e shtetit shqiptar për të siguruar veprimtarinë e rregullt dhe ligjore të ndërtimeve të mbrojtura dhe të garantuara posaçërisht nga legjislacioni penal shqiptar nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive kjo vepër është konsumuar me veprime aktive kriminale. Të pandehurit, në kundërshtim me ligjin dhe pa qenë të pajisur me leje ndërtimi apo me aplikim për leje, kanë kryer veprime që konsistojnë në ndërtimin e paligjshëm”.

Pas hetimit dhe shqyrtimit, Komisioni konstaton se subjekti ka demonstruar qëndrime të ndryshme në veprimtarinë e tij si magjistrat dhe në veprimtarinë e tij jashtë këtij funksioni.

Subjekti do të duhej të kishte marrë të gjitha masat e arsyeshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të realizuar ndërtimin që dëshironte dhe konkretisht sipas ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ku parashikon dhe marrjen e lejes së ndërtimit, që sipas këtij ligji gjen këtë përkufizim “Leje ndërtimi që është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve përkatëse”, pra duhej të ishin respektuar të gjitha procedurat ligjore dhe pagesat respektive sipas ligjit. Në këtë mënyrë do të mund të kishte shmangur cenimin e dinjitetit të magjistratit.

Referuar deklarimit të subjektit që “paraprakisht i është drejtuar organeve vendore që duhej ta pajisnin me leje ndërtimi, por për shkak të bllokimit të lejeve nuk u bë i mundur”, Komisioni vlerëson se ky deklaram nuk qëndron, pasi subjekti nuk paraqiti asnjë dokument justifikues për të vërtetuar këtë aplikim në atë kohë dhe gjithsesi mungesa e një lejeje të tillë, nuk e justifikon faktin e ndërtimit pa leje nga subjekti, me detyrë gjyqtar.

Gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se ALUIZNI Korçë, krahas dokumenteve të tjera, ka bashkangjitur edhe fotot e shtëpisë së subjektit, ku duket mjaft qartë shtëpia e ndërtuar në fshatin B. Nga këto foto vërehet se shtëpia është e ndërtuar pjesërisht me gurë dekorativë, që janë mjaft të kushtueshëm, si dhe pjesa tjetër me dru që po përsëri është mjaft i kushtueshëm si material ndërtimi.

Subjekti në deklaratën “Vetting” ka deklaruar shumën 2,600,000 lekë për ndërtimin dhe mobilimin e kësaj shtëpie.

Për të saktësuar ndarjen e shumës së deklaruar është pyetur subjekti, i cili, në përgjigje të pyetësorit, më datë 03.09.2018, ka sqaruar se si shumë për mobilimin e kësaj shtëpie ka shpenzuar vetëm shumën 500,000 lekë. Pra, sipas këtij deklarimi, del që shtëpia ka kushtuar rreth 2,100,000 lekë vetëm si ndërtim.

Nga faturat e depozituara nga vetë subjekti për shpenzimet e bëra për ndërtim dhe mobilim, rezulton se shuma totale është 1,438,288 lekë, ndërkohë diferenca prej 661,712 lekë mbetet e padokumentuar.

Nisur nga pamjet fotografike që disponon Komisioni, të vëna në dispozicion nga ALUIZNI dhe të fotografuara në datën 20.08.2013, si dhe sipërfaqja e shfrytëzueshme e shtëpisë, lind dyshimi se vlera e deklaruar për ndërtimin dhe mobilimin e shtëpisë (deklaruar nga vetë subjekti) në B. nuk është vlera reale, por ka kushtuar më shumë sesa është pretenduar nga subjekti. Pemët dekorative, shatërvani, oborri i shtruar me bar dhe me rrugica ndarëse me gurë të gdhendur, si dhe muri rrethues me gurë dhe kangjella duken qartazi se janë të kushtueshme.

Në përfundim të hetimit administrativ, ka rezultuar:

- ⊗ Mosdeklarim i burimit të krijimit të kësaj pasurie si në deklaratën “Vetting” 2017, ashtu edhe në atë të periodike të vitit 2014;
- ⊗ Deklarim i rremë në deklaratën “Vetting”, në lidhje me mënyrën e përfitimit të truallit prej 470 m², ku ka ndërtuar shtëpinë;
- ⊗ Cenim i figurës dhe dinjitetit të magjistratit, duke mos respektuar legjislacionin në fuqi në fushën e ndërtimeve;
- ⊗ Mosdeklarim në deklaratën periodike të vitit 2013 i shtëpisë së ndërtuar në B., pa u regjistruar në ZVRPP-në Korçë, si dhe shpenzimeve të kryera për këtë ndërtim;
- ⊗ Mospërputhje deklarimi për sa i përket vlerës së shtëpisë. Në deklaratën “Vetting” ka deklaruar vlerën 2, 600, 000 lekë për ndërtim dhe mobilim, ndërsa në deklaratën e 2014 ka deklaruar vlerën 2, 200, 000 lekë.

Për të sqaruar pozicionin e tij, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me gjetjet e Komisionit. Në shpjegimet e tij me shkrim, si dhe gjatë deklarimit në seancë dëgjimore, subjekti ka pretenduar se:

“Në lidhje me shtëpinë e ndërtuar në fshatin tim të lindjes, B. Korçë, të legalizuar dhe regjistruar, theksoj faktin se:

-Të ardhurat për ndërtimin e saj janë kursimet e akumuluar nga viti 2010-2013 nga të gjitha të ardhurat. Ky fakt provohet me gjendjen e kursimeve që kam pasur të akumuluar në fund të vitit 2013, bashkëngjitur fotokopje të deklaratës vjetore të vitit 2013, shih faqja 7 e saj, së cilës i shtohen dhe kursimet vjetore të vitit 2014.

-Trualli ku është ndërtuar shtëpia, ashtu siç dhe e kam shpjeguar gjatë pyetjeve të bëra, është një truall i poseduar nga familja ime prej 40 vjetësh, pa asnjë ndryshim konfiguracioni, me dy pika statike, rrugë publike dhe me dy kufitarë, të afërmit e mi, përkatësisht gjyshi dhe xhaxhai. Dua të bëj një sqarim në lidhje me atë që përshkruhet në relacion, në lidhje me burimin e krijimit të truallit prej 470 m². E kam përdorur termin si anëtar i familjes bujqësore, nisur nga fakti se ky truall fillimisht u shënuar në aktin e marrjes së tokës në pronësi nga komisioni i ndarjes së tokës së fshatit dhe se më pas, saktësimi i konfigurimit dhe procedura për regjistrimin e tij, është bërë në bazë të vendimit nr. 608, të Këshillit të Ministrave, nga institucionet legjitime të këtij shteti, duke mos u kontestuar nga askush, me punonjës të të cilëve, siç ju me të drejtë keni konstatuar nuk kam pasur asnjë konflikt interesi. Në këtë këndvështrim, deklaroj me përgjegjësi të plotë se, asnjëherë dhe në asnjë çast nuk kam pasur qëllim që të deklaroj në mënyrë të rremë një pronë, që familja ime e ka poseduar qetësisht prej gati 40 vjetësh, e që thjesht e vetëm u regjistrua si pronë, pa përfituar as dhe një metër. Kjo ka qënë dhe arsyeja e vetme e deklarimit në këtë mënyrë në deklaratën “Vetting” dhe e asnjë qëllimi tjetër, pasi nuk ekzistonte asnjë lloj motivi apo

interesi në këtë rast, as të përfitoja diçka të re dhe as të lija diçka që posedonte familja ime prej dekadash. Të gjitha veprimet e kryera për regjistrimin janë ligjore dhe se këtë fakt e kanë konfirmuar dhe organet përkatëse në shkresat dërguar jush, të cilat janë cituar në relacion.

-Shtëpia është ndërtuar në vitin 2013, pasi jam paraqitur fillimisht në organet kompetente ku kam kërkuar verbalisht pajisjen me leje ndërtimi, konform të gjitha rregullave, e cila nuk më është mundësuar për shkak të bllokimit të tyre në këtë periudhë, por edhe më pas. Legalizimi i këtij objekti i kryer, më pas, provoi se ndërtimi nuk cenonte asnjë kondicion urbanistik, apo normë detyruese ligjore, çka nuk do të lejonte këtë bërjen e legalizimit. Një fakt të tillë e kam shpjeguar në përgjigjet e pyetjeve të bëra prej jush. Për të provuar këtë pretendim bashkëngjitur shpjegimeve keni vërtetimin nr. (***) prot, datë 11.12.2018, të Njësisë Administrative L., Bashkia Maliq.

-Shtëpia është deklaruar në vitin 2014, atëherë kur janë bërë pagesat përkatëse, duke u pakësuar kursimet e akumulura, kohë në të cilën është dhe ligjëruar si pasuri. Procedurat e ndjekura për legalizimin e saj kanë qënë të rregullta dhe ligjore, nga organi i specializuar shtetëror, i ngritur për këtë qëllim, që është ALUIZNI. Këtë fakt e provoj së fundmi dhe me vërtetimin nr. (***) prot, datë 11.12.2018, të Drejtorisë së ALUIZNI-t, Korçë, bashkëngjitur këtyre shpjegimeve.

-Në lidhje me mobilimin e saj theksoj se ajo ka kushtuar 500.000 lekë dhe prandaj është shënuar 2.600.000 lekë në total. Theksoj se edhe shumat për mobilimin e saj janë bërë brenda mundësive financiare të mia, të cilat i kam të justifikuara me pasqyrat financiare. Ato janë bërë në mënyrë progresive në vite. Ndërsa në vitin e ndërtimit kam shpenzuar vetëm 100.000 lekë për mobilim. Prandaj në momentin e ndërtimit të saj, së bashku me mobilimin fillestar të kryer kam deklaruar 2. 200,000 lekë, shpenzime të cilat ishin nga kursimet e akumuluar. Vlera tjetër prej 400.000 lekë është kryer në mënyrë progresive. Nga ana tjetër theksoj faktin se, i qëndroj deklarimeve të mia që, guri i përdorur nuk është gur dekorativ, por gur i zonës malore ku ndodhet fshati, i cili i përkiste një shtëpie të vjetër të rrënuar, që konstatohet lehtësisht nëse shihet në vend, pa pasur asnjë kosto ekonomike. Rrugicat janë bërë me plloçat e vjetra të po kësaj shtëpie, pasi shtëpitë në këtë zonë për shkak të kushteve atmosferike janë të mbuluara me plloçë apo rrasë guri, po të zonës. Pra, ka pasur, qoftë guri, e qoftë plloça, vetëm kostot e vendosjes së tyre, por jo të blerjes. Ndërsa rrethimi dhe mirëmbajtja e tij është bërë nga prindërit dhe vëllai, pasi shtëpia ka të njëjtin oborr me shtëpinë e vjetër, në pronësi të tyre. Ndërkohë që të ardhurat e tyre, familjes së vëllait dhe prindërve, për shkak se të gjithë janë në marrëdhënie pune, shkojnë rreth 2 milion lekë në vit. Për pjesën e pambuluar me fatura, prej rreth 661.712 që ju citoni me të drejtë në relacion deklaroj se ato janë pjesë punimesh të kryera nga punëtorë të ndryshëm.”

Në përfundim, Komisioni, pasi mori në shqyrtim provat e administruar gjatë hetimit administrativ, provat e depozituara nga subjekti, si dhe dëgjoi shpjegimet e tij në seancën dëgjimore, vlerëson se subjekti ka qënë shumë i përgjithshëm dhe aspak bindës në shpjegimet e tij, në lidhje me rezultatet e hetimit në këtë pikë.

Subjekti ka sqaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi i ka kaluar barra e provës, dhe jo në deklaratën “Vetting”, sipas detyrimit kushtetues.

Në lidhje me mënyrën e përfitimit të tokës prej 820 m² nga ana e babait të tij, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim ligjor, se si ka evoluar sipërfaqja e përfituar nga 300 m² në 820 m², mënyrën e përfitimit dhe regjistrimit të kësaj pasurie nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 08.09.2014 të Komunës L., duke i konsideruar si veprime të kryera nga institucionet legjitime dhe të pakontestuara nga askush, megjithëse këto institucione janë vënë në lëvizje nga personi i interesuar (babai i subjektit).

Në shpjegimet e tij, por edhe në seancë, subjekti nuk dha asnjë sqarim, në lidhje me ndërtimin e shtëpisë në fshatin B., pa leje ndërtimi. Ai është mjaftuar me faktin se ka kërkuar verbalisht mundësinë e pajisjes me leje ndërtimi, dhe meqënëse nuk i është dhënë, ai ka proceduar me ndërtim të paligjshëm. Subjekti, gjithashtu nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me qëndrimin e tij si gjyqtar në rastet e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore me objekt ndërtim të paligjshëm nga ana e qytetarëve të ndryshëm, për të cilët është shprehur me vendim për dënim me gjobë/burgim, sipas ligjit. Në këto kushte Komisioni vlerëson se subjekti, megjithëse në funksionin e gjyqtarit/kryetarit të Gjykatës, nuk ka respektuar legjislacionin në fuqi në fushën e ndërtimit, duke dëmtuar në këtë mënyrë figurën e gjyqtarit dhe duke cenuar besimin e publikut tek drejtësia.

Në lidhje me mosdeklarimin e këtij ndërtimi në vitin 2013, subjekti ka pretenduar deklarimin e tij në momentin e përfundimit dhe regjistrimit, pra në vitin 2014, por nuk ka sqaruar arsyet e modeklarimit të shpenzimeve për këtë ndërtim në vitin 2013.

Për sa i përket vlerës së ndërtimit dhe dekorimit të shtëpisë dykatëshe në B., Korçë, megjithë pyetjet e bëra në seancë me qëllim qartësimin e fakteve, Komisionit nuk iu krijua bindja për vërtetësinë e vlerave të deklaruara nga subjekti si shpenzime, në mënyrë të veçantë për dekorimin e saj.

Në përfundim të analizës Komisioni vlerëson se:

- Subjekti, ndryshe nga sa detyrimi kushtetues parashikon, nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”.
 - Subjekti ka kryer deklarim të rremë në lidhje me mënyrën e përfitimit të truallit prej 470 m², mbi të cilin ka ndërtuar shtëpinë dykatëshe në fshatin B., Korçë.
 - Komisioni çmon se referuar faktit të ndërtimit të paligjshëm, i kryer në vitin 2013, por i deklaruar në vitin 2014, nga ana e subjektit me një detyrë të rëndësishme dhe të besuar, për të gjykuar dhe për të dhënë drejtësi, kompromenton shumë rëndë figurën e tij si gjyqtar/kryetar gjykate në dhënien e drejtësisë.
 - Subjekti nuk ka kryer deklarimin e shpenzimeve të kryera për këtë ndërtim në vitin që i ka kryer, pra në vitin 2013, por i ka deklaruar në vitin 2014, kur ka kryer edhe procedurat për legalizmin e këtij ndërtimi.
2. **Tokë bujqësore 2970 m²** në B., Bashkia Maliq, përfituar si anëtar i familjes bujqësore me përfituar me ligjin nr.7501 së bashku me truallin ku është ndërtuar shtëpia.
Burimi i krijimit: Përfituar nga ligji nr.7501
Vlera: Nuk është vendosur vlera respektive
Pjesa takuese: 100 %

Në lidhje me këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Vërtetim lëshuar nga Njësia Administrative L., nr. (***) prot., datë 23.01.2017, që vërteton se Admir Belishta ka qenë banor i fshatit B. dhe ka përfituar nga ligji nr. 7501, 2970 m² tokë arë bashku me truallin;
- Vërtetim i lëshuar nga Njësia Administrative L., nr. (***) prot., datë 21.10.2016, duke vërtetuar se Admir Belishta ka paguar taksat dhe tarifat vendore për vitin 2016.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. (***) prot., datë 02.02.2018 drejtuar ZVRPP-ve vendore për të dhënë informacion në lidhje me pasuritë e paluajtshme të subjektit A. Belishta dhe personave të lidhur me të.

ZVRPP-ja Korçë me shkresën nr. (***) Prot., datë 12.02.2018 ka vënë në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

- Shkresë nr. (***) prot., datë 05.03.2018 drejtuar ZVRPP-së Korçë ku i është kërkuar informacion shtesë.

ZVRPP-ja Korçë me shkresën nr(***)prot., datë 15.03.2018 drejtuar Komisionit ka dërguar informacionin dhe ka dërguar dhe listën e printimit të III-të, e cila përmban informacionin respektiv.

- Shkresë nr. (***)prot., datë 05.03.2018 drejtuar Njesisë Administrative L. ku i kërkohet informacion në lidhje me sipërfaqjen e tokës që ka përfituar subjekti Admir Belishta dhe i ati A. B. sipas ligjit nr. 7501.

Bashkia Maliq (Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural) me shkresën nr(***)prot., datë 20.04.2018 ka bashkëngjitur vërtetimet e Njesisë Administrative L.

- Shkresë nr. (***) prot., datë 01.10.2018, drejtuar Njesisë Administrative L., Korçë, ku i kërkohet informacion në lidhje me mospërputhshmërinë e sipërfaqjes së tokës bujqësore në B. konfirmuar me dy sipërfaqje të ndryshme po nga vetë kjo njësi.

Njësia L. ka kthyer përgjigje nëpërmjet Bashkisë Maliq.

Arsyetimi ligjor:

Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar në pronësi tokë bujqësore e ndodhur në fshatin e lindjes B., Bashkia Maliq, përfituar si anëtar i familjes bujqësore me ligjin nr. 7501, sipërfaqja e përgjithshme 2970 m² së bashku me truallin, ku është ndërtuar shtëpia. Si burim për krijimin e saj ai ka deklaruar ligjin nr. 7501.

Për të vërtetuar deklarinimin e nga subjekti Komisioni kërkoi informacion nga ZVRPP-ja Korçë, e cila informon se A. A. B.(i ati i subjektit), sipas AMTP-së nr. (***), ka të regjistruara në zonën kadastrale nr. (***), në total 11878 m² (në të cilat 11628 m² janë arë dhe 250 m² janë truall). Në bazë të ligjit nr.7501, subjekti, si anëtar i familjes bujqësore me 4 (katër) anëtarë përfiton ¼ pjesë të kësaj pasurie, në total $11878:4 = 2969.5$ m². Në deklarinimin e tij, subjekti e ka rrumbullakosur, duke deklaruar 2970 m², së bashku me truallin, ku është ndërtuar shtëpia.

Nisur nga analiza e bërë në pikën II, rezulton se subjekti ka përfituar 470 m² truall, bazuar në vendimin nr. 3, datë 08.09.2014 të Komunës L., vendim ky i nxjerrë mbështetur në VKM-në nr. 608, datë 05.09.2012.

Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar pronësinë mbi 2970 m², në të cilën ka përfshirë edhe truallin prej 470 m². Pra, nga sipërfaqja e deklaruar nga subjekti prej 2970 m², po të zbresim sipërfaqen e truallit prej 470 m², i mbeten në pronësi tokë bujqësore (arë) sipërfaqja prej 2500 m².

Në lidhje me këtë pasuri, është pyetur subjekti dhe i është kërkuar të përcaktojë sasinë e tokës që ka përfituar sipas ligjit nr.7501, origjinën e saj, organin kompetent.

Subjekti ka deklaruar se referuar AMTP-së si dhe vërtetimit të Komunës L., ku përfshihet fshati B., sipërfaqja për frymë për çdo anëtar është pothuaj 3000 m². Pra, subjekti pretendon se vlera e përfituar sipas ligjit është 3000 m². Ai ka bashkëngjitur dhe AMTP-në, duke sqaruar se organi kompetent për dhënien e tokës bujqësore të fshatit ka qenë komisioni i ndarjes së tokës, duke dokumentuar veprimin me plotësimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi.

Nga hetimi administrativ rezulton se Bashkia Maliq (Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural) me shkresën nr. (***)prot., datë 20.04.2018 ka dërguar pranë Komisionit vërtetimet e Njësisë Administrative L. dhe konkretisht vërtetimin nr. (***)prot., datë 19.04.2018 në të cilin vërtetohet se subjekti Admir Belishta ka përfituar tokë arë me sipërfaqe 3600 m², ndërsa me vërtetimin nr. (***) prot., datë 19.04.2018 për shtetasin A. B. ka konfirmuar se ka përfituar në total 11,878 m² nga ligji nr.7501.

Nga krahasimi i deklaramit të subjektit në Deklaratën “Vetting” me dokumentin e administruar zyrtarisht nga organi kompetent, Komisionit i lindën dyshime se subjekti ka fshehur pasurinë/ ka kryer deklarim të rremë për pasurinë prej 900 m² tokë bujqësore (arë). Në përgjigjen e datës 17.10.2018 Komuna L. sqaron se norma për frymë e përfitimit të tokës në fshatin B. ka qenë 3600 m². Në këtë mënyrë, Admir Belishta ka përfituar sipërfaqe faktike prej 2970 m², në bazë të përllogaritjes sipas ligjit nr. 7501.

➤ Komisioni konstaton se subjekti ka qenë i saktë në deklaramet e tij.

3. **Autoveturë e tipit Benz-Mercedes** 220, viti 2002, me targa (***) blerë me kontratën nr. (***) rep., nr. (***)kol., datë 17.04.2013.

Burimi i krijimit: Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit

Çmimi i blerjes: 600,000 lekë

Pjesa takuese: 100%

Në lidhje me këtë pasuri, subjekti nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

➤ Shkresë nr. (***) prot., datë 02.02.2018, drejtuar DPTRRSH-së për të vënë në dispozicion të gjithë dosjen e plotë të këtij mjeti.

DPTRRSH-ja me shkresën nr. (***)prot., datë 21.02.2018 ka depozituar dosjen e plotë të automjetit Mercedes-Benz S 320 CDI, ngjyra e zezë, vit prodhimi 2002.

- Shkresë nr. (***) prot., datë 08.03.2018, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë ku kërkohet informacion në lidhje me veprimet noteriale të kryera në zyrat noteriale për subjektin A. Belishta dhe familjarët e tij.

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. (***)prot., datë 19.03.2018 ka vënë në dispozicion listën me veprimet noteriale të kryera në zyrat noteriale nga ana e subjektit dhe familjarëve të tij.

- Shkresë nr(***)prot., datë 30.03.2018, drejtuar noteres E. K.

Notere E. K. me shkresën datë 04.04.2018 ka vënë në dispozicion kontratën nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 17.04.2013 me shitës P. A. dhe blerës Admir Belishta, me çmim blerje 600,000 lekë. Kjo vlerë është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

Arsyetimi ligjor:

Në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi pronësinë mbi këtë mjet, por në kundërshtim me detyrimin kushtetues, ai nuk ka deklaruar burimin e blerjes.

Ky mjet është blerë me kontratën nr. (***)rep., nr. (***) kol., datë 17.04.2013 me shitës P. A. dhe blerës Admir Belishta, në shumën 600, 000 lekë, duke deklaruar likuidimin jashtë zyrës noteriale. Përshkrimi i mjetit në këtë kontratë është: autoveturë Mercedes Benz 220, ngjyrë e zezë, naftë, viti i prodhimit 2002, automatik.

Në dokumentacionin bashkëngjitur dosjes së këtij mjeti të dërguar nga DPSHTRR-ja, rezulton edhe kontrata e shitblerjes së këtij automjeti me nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 11.02.2010 me palë shitëse E. B. dhe palë blerëse P. A. për automjetin Mercedes Benz S 320 CDI, ngjyra e zezë, viti prodhimit 2002 me çmim shitje 15,000 euro.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet përshkrim i ndryshëm i të njëjtit mjet në dy kontrata të ndryshme.

Tek të dhënat e mjetit Benz Mercedes, në kontratën ku palë blerëse është subjekti, është shënuar tipi Mercedes Benz 220, ndërkohë që në të vërtetë tipi është S 320. Lindin dyshime të arsyeshme se ky specifikim mund të jetë vënë qëllimisht nga palët në kontratë për të justifikuar çmimin e blerjes.

Duke iu referuar parametrave teknikë të mjeteve, mjeti Benz S 320 është mjet që kushton më shtrenjtë, ka një fuqi motorike më të madhe, harxhon më shumë karburant dhe është mjet tipik më luksoz për nga kategoria e markës Benz sesa mjeti Benz 220 CDI, si për nga çmimi që është më i lirë, ashtu edhe nga fuqia motorike më e vogël, dhe është në një nivel më të ulët luksi se tipi S 320.

Referuar tregut të sotëm nëpër faqe zyrtare të shitblerjes së këtyre mjeteve në shtetin gjerman (pasi dhe ky mjet ka këtë si vend origjine) dhe konkretisht faqes zyrtare www.mobile.de rezulton që çmimi mesatar i këtij mjeti me po ato parametra edhe në ditët e sotme ka si çmim mesatar 4000 – 7000 euro pa përfshirë çmimin e doganës, që do të paguhet, shpenzimet e tjera si taksa, karburant, siguracion që duhen për të ardhur makina deri në territorin shqiptar.

Për më tepër shitësi P. A. i ka shitur Admir Belishtës automjetin Benz S 320 CDI me shumën 600,000 lekë (ose rreth 5000 euro) pas 3 vitesh kur ai vetë e ka blerë më parë me çmim 15,000 Euro (ose 3 herë më pak).

Për të sqaruar këtë situatë është pyetur subjekti, i cili ka deklaruar se ky mjet është blerë me kursime nga paga dhe honoraret. Në lidhje me shtetasin P. A. subjekti deklaroi se nuk ka asnjë lloj lidhje apo njohje përveç faktit të blerjes së mjetit. Për sa i përket diferencës në çmim, subjekti deklaroi se ka qenë takim rastësor dhe është dakordësuar çmimi i blerjes dhe nuk ka patur dijeni në lidhje me çmimin e blerjes nga ana e shitësit më parë. Subjekti deklaroi gjithashtu se nuk ka pasur ndonjë proces gjyqësor me këtë shtetas. Subjekti nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument provues të pagimit të shumës për blerjen e mjetit.

Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti del me rezultat negativ në shumën -564,620 lekë, duke vënë në dyshim aftësitë blerëse për këtë mjet në vitin 2013.

Përshkrimi	2013
Të ardhurat	1,472,965
Nga pagat dhe shpërblimet e subjekti	1,371,706
Nga pagat dhe shpërblimet e bashkëshortes	101,259
Shpenzime	1,280,329
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	521,793
Shpenzime udhëtimi	658,286
Pasuri	757,256
Automjet tip Benz, vit prodhimi 2002 blerë në 2013	600,000
Kursime (Gjendje në fund-gjendje në fillim)	157,256
Të ardhura - shpenzime – pasuri	-564,620

Në përfundim të hetimit, rezultoi se:

- ⊗ Subjekti nuk ka deklaruar burimin e kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”.
- ⊗ Ka dyshime për fiktivitet në çmimin e blerjes së këtij automjeti.
- ⊗ Subjekti nuk ka patur mundësi financiare për blerjen e mjetit.

Subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me këto rezultate të hetimit. Në qëndrimin e tij, subjekti ka sqaruar se :

“Në lidhje me blerjen e mjetit, të llojit Benz, theksoj faktin se ashtu siç e kam deklaruar edhe në shpjegimet e pyetjeve tuaja, deklaroj me përgjegjësi se këtë mjet e kam blerë në vlerën 600.000 lekë, në cash, fakt që është dokumentuar edhe në kontratën e shitblerjes së tij. Për blerjen e tij disponoja të gjitha mundësitë financiare, fakt që provohet me pasqyrat e analizës financiare të bëra. Kjo është vlera e vërtetë e blerjes dhe se arsyet e shitjes në

*këtë vlerë nga shitësi nuk kam pas detyrim dhe as mundësi reale për t'i ditur, sikundër as vlerën fillestare të blerjes prej tij të këtij mjeti. Megjithatë, ndodhur para barrës së provës kam kërkuar shitësin, të cilin siç e kam theksuar, e kam njohur në rrethana krejt rastësore dhe nuk e kam takuar asnjëherë më pas, i cili ka hartuar një deklaratë noteriale në lidhje me këtë aspekt, duke u dhënë arsyet e shitjes në këtë vlerë si dhe shprehur gatishmërinë për të dhënë dëshmi për këtë fakt. Për të provuar këtë moment po paraqes si provë bashkëngjitur shpjegimeve deklaratën noteriale nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 11.12.2018. Theksoj gjithashtu faktin se, ky mjet është përdorur për një periudhë të gjatë kohe edhe për nevojat e institucionit, për shkak të problematikës së mjetit zyrtar të institucionit. Sot gjendja e tij teknike paraqitet me probleme dhe se askush nuk shfaq interes për blerjen e tij edhe në vlerën 300.000 lekë.”*

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se mbetet i paqartë fakti i blerjes së këtij mjeti me një çmim shumë më të ulët nga çmimi i tregut. Megjithëse është e vërtetë që subjekti nuk ka patur detyrim ligjor të dinte çmimin fillestar të mjetit, mbetet fakt që në kontratën e shitblerjes, të dhënat e makinës nuk përkojnë me të dhënat reale që pasqyrohen në dokumentacionin e mjetit. Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim mbi këtë fakt. Megjithëse pretendoi për rastësi në njohje me shitësin e kësaj makine, subjekti nuk arriti të shpjegojë se si arriti ta kontaktojë këtë shtetas për t'i marrë deklaratën noteriale të depozituar si provë, duke mos e bindur Komisionin se njohja mes tyre ka qenë rastësore dhe se çmimi i blerjes së këtij mjeti nuk ka qenë favorizues.

Në lidhje me aftësitë financiare, për blerjen e mjetit, pas rillogaritjes, rezulton se subjekti ka patur mungesë të të ardhurave për blerjen e mjetit në shumën 489,130 lekë.

Përshkrimi	2013
Të ardhurat	1,574,224
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti	1,472,965
Nga pagat dhe shpërblimet bashkëshortja	101,259
Shpenzime	1,306,098
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	521,793
Shpenzime udhëtimi	604,305
Pasuri	757,256
Automjet tip Benz, vit prodhimi 2002 blerë në 2013	600,000
Kursime (gjendje në fund-gjendje në fillim)	157,256
Të ardhura - shpenzime – pasuri	-489,130

Në përfundim, Komisioni vlerëson se:

- Provat dhe shpjegimet e subjektit, kanë përmirësuar situatën e tij financiare në përbalimin e blerjes së kësaj pasurie, por përsëri rezultati del negativ.

- Subjekti nuk arriti të bindë Komisionin për vërtetësinë e çmimit të blerjes së këtij mjeti.

4. **Në emër të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. E. B.**, subjekti nuk ka deklaruar për sa i përket pasurive të paluajtshme.

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. (***) prot., datë 30.03.2018, drejtuar noterit B. Z. për të vënë në dispozicion aktet noteriale të kryera pranë këtij noteri nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Noteri B. Z. me shkresën nr. ekstra prot., datë 14.04.2018 ka dërguar aktet e kërkuara noteriale.

- Shkresën drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile nr. (***)prot., datë 05.03.2018 për të verifikuar faktin e ndryshimit të statusit të gjendjes civile të subjektit A. Belishta.

DPGJC-ja me shkresën nr. (***) Prot., datë13.03.2018 ka konfirmuar se subjekti A. Belishta ka lidhur martesë ligjore në Bruklin të SHBA-së më datë 10.12.2012 dhe veprimet për zbatimin e aktit të martesës janë bërë më datë 07.11.2013.

Arsyetimi ligjor:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se pranë noterit B. Z. është bërë një deklaratë noteriale nr. (***) rep., nr.(***)kol., datë 25.01.2017 me deklaruese E. V. B. si bashkëshortja e subjektit Admir Belishta, e cila deklaron:

*“Jam trajtuar me tokë bujqësore, truall dhe banesë me ligjin nr. 7501 për prona të ndodhura në fshatin M., Devoll, sipas AMTP-së nr. (***), datë 08.12.2005 me kryetar të familjes bujqësore babain tim V. K. Meqenëse unë jam larguar nga familja bujqësore, sepse jam martuar, për pjesën time që kam në tokën bujqësore, truall dhe ndërtesë, nuk kam kërkuar të marr nga familja bujqësore e babait tim. Deklaroj se heq dorë nga çdo e drejtë që kam përfutur në këto pasuri dhe nuk kam asnjë pretendim në lidhje me këto prona, që jam bashkëpronare, unë deklaroj me kryetar familje bujqësore, babain tim.”*

E. K. ka lidhur martesë me subjektin, duke u bërë person i lidhur me të, më datë 07.11.2013. Nga shqyrtimi i deklaramëve ndër vite të subjektit, konstatohet se pronësia e bashkëshortes së tij nuk është deklaruar asnjëherë.

Në përfundim të hetimit administrativ, u konstatua:

- ⊗ Mosdeklarim i pasurive të paluajtshme të bashkëshortes E. K. B., si përfituese e ligjit nr. 7501 sipas pjesës takuese nga familja e origjinës i tokës bujqësore, truall dhe i shtëpisë, që nga viti 2013, viti i martesës së tyre në Republikën e Shqipërisë, që e bën person të lidhur, deri në 25 janar 2017, ditën që ka hequr dorë nga bashkëpronësia.

Subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me këtë rezultat të hetimit.

Në lidhje me mosdeklarimin e pasurisë së bashkëshortes, E. K. B., nga vajzëria e saj, subjekti ka sqaruar se është plotësisht i vërtetë fakti që bashkëshortja e tij ka përfituar tokë bujqësore, dhe se ka qënë bashkëpjesëtare në shtëpinë e prindërve dhe truallin funksional të kësaj shtëpie dhe se kjo nuk është deklaruar në momentin fillestar të lidhjes së martesës. Kjo ka ardhur si rezultat i një neglizhence apo harrese, duke mos patur asnjë qëllim tjetër. Kjo nisur edhe nga fakti se nga kjo pasuri, nuk është përfituar asnjë lloj e ardhure. Për të provuar këtë fakt subjekti ka paraqitur si provë bashkëngjitur shpjegimeve, vërtetimin nr. (*)prot, datë 11.12.2018, të Njësisë Administrative M., Bashkia Devoll.**

Pasi dëgjoi subjektin në seancë, si dhe mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij, Komisioni vlerëson se subjekti, ka patur detyrimin për deklarim të pasurive të bashkëshortes, që nga momenti i lidhjes së tyre në martesë. Duke qënë se dorëzimi i deklaratës “Vetting” pranë ILDKPKI-së është bërë vetëm 5 (pesë) ditë pas heqjes dorë nga kjo pasuri, nuk mund të pranohet pretendimi i subjektit për neglizhencë apo harresë, përkundrazi, duket sikur këto dy ngjarje janë të lidhura me njëra-tjetrën.

5. Analiza financiare e subjektit ndër vite

Duke u nisur nga deklarimet e subjektit ndër vite, dokumentacioni i depozituar pranë Komisionit, dhe dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare, në raport me shpenzimet e kryera.

Nga dokumentacioni i administruar në dosje konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar vlerën prej 1,500,000 lekë, deklaruar si kursime në vitin 2003. Gjithashtu mungon dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar dhurimin e bërë nga prindërit e subjektit në shumën 1,400,000 lekë, në vitin 2004, i cili ka shërbyer si burimi financiar për blerjen e apartamentit në qytetin e Korçës në vitin 2009.

Në përgjigje të pyetjeve nga ana e Komisionit, subjekti ka shpjeguar dhurimin e bërë nga prindërit me arsyetimin se ishte në pamundësi objektive për të vënë në dispozicion një dokumentacion të tillë, pasi askush në kohën e krijimit të këtyre të ardhurave bujqësore apo blegtorale nuk jepte dokumentacion që të provonte këto shitje. Gjithashtu as subjekti nuk kishte detyrim ligjor për të marrë një dokument të tillë. Ndërkohë deklaroi se këto të ardhura janë pjesë e kursimeve të familjes së tij prindërore qysh nga viti 1991.

Mbetet e paqartë masa e fitimit të prindërve në këtë periudhë, tatimi i paguar për këtë shumë dhe cili është mekanizmi i llogaritjes për pjesën që i ka takuar subjektit.

Përshkrimi	2007	2008
Të ardhurat	980,725	1,529,693
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti	980,725	1,079,693
Të ardhura nga shitja e makinës	-	450,000
Shpenzime	496,273	469,316
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	191,283	191,283
Shpenzime udhëtimi	244,990	218,033
Shpenzime qeraje	60,000	60,000
Pasuri	477,734	690,197

Kursime (gjendje në fund-gjendje në fillim)	477,734	690,197
Të ardhura -shpenzime – pasuri neto	6,718	-9,930

Bazuar tek analiza e mësipërme financiare rezulton se për vitin 2008 subjekti i rivlerësimit nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera gjatë këtij viti. Për periudhën 2011-2014, bazuar në analizën e mëposhtme, subjekti nuk arrin të justifikojë me të ardhura të ligjshme, shpenzimet e kryera.

Përshkrimi	2011	2012	2013	2014
Të ardhurat	1,653,853	1,112,134	1,472,965	1,450,016
Nga pagat dhe shpërblimet e subjektit	1,653,853	1,112,134	1,371,706	1,282,886
Nga pagat dhe shpërblimet e bashkëshortes	-	-	101,259	167,130
Shpenzime	782,516	759,943	1,280,329	3,722,699
Shpenzime për ndërtim shtëpie në B.	-	-	-	2,600,000
Shpenzime shkollimi	-	-	-	210,000
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	191,283	191,283	521,793	521,793
Shpenzime udhëtimi	591,233	568,660	658,286	390,907
Pasuri	1,474,931	581,825	757,256	-1,694,037
Automjet tip Benz, vit prodhimi 2002 blerë në 2013	-	-	600,000	-
Kursime (gjendje në fund-gjendje në fillim)	1,474,931	581,825	157,256	-
Të ardhura - shpenzime – pasuri	-603,594	-229,635	-564,620	-578,646

Subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me këtë rezultat të hetimit.

Në përfundim, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, Komisioni ka marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimeve të vërtetuara nga subjekti, sipas dokumentacionit shoqërues. Situata financiare e subjektit (e shprehur në lekë) ka ndryshuar si më poshtë:

Përshkrimi	2007	2008
Të ardhurat	980,725	1,529,693
Nga pagat dhe shpërblimet subjekti	980,725	1,079,693
Të ardhura nga shitja e makinës	-	450,000
Shpenzime	377,781	287,006

Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	191,283	191,283
Shpenzime udhëtimi	126,498	35,723
Shpenzime qiraje	60,000	60,000
Pasuri	477,734	1,070,307
Kursime (gjendje në fund-gjendje në fillim)	477,734	1,070,307
Të ardhura -shpenzime – pasuri neto	125,210	172,380

Përshkrimi	2011	2012	2013	2014
Të ardhurat	1,766,846	1,184,280	1,574,224	1,483,340
Nga pagat dhe shpërblimet e subjektit	1,766,846	1,184,280	1,472,965	1,316,210
Nga pagat dhe shpërblimet e bashkëshortes	-	-	101,259	167,130
Shpenzime	903,738	737,349	1,306,098	3,951,793
Shpenzime për ndërtim shtëpie në B.	-	-	-	2,600,000
Shpenzime mobilimi	180,000	180,000	180,000	280,000
Shpenzime shkollimi	-	-	-	210,000
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	191,283	191,283	521,793	521,793
Shpenzime udhëtimi	532,455	366,066	604,305	340,000
Pasuri	1,474,931	581,825	757,256	-1,694,037
Automjet tip Benz, vit prodhimi 2002 blerë në 2013	-	-	600,000	-
Kursime (gjendje në fund-gjendje në fillim)	1,474,931	581,825	157,256	1,694,037
Të ardhura - shpenzime – pasuri	-611,823	-134,894	-489,129	-774,415

- Në përfundim të analizës financiare, subjekti rezulton me pamjaftueshmëri të ardhurash për përbalimin e shpenzimeve të kryera.

Konkluzion përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë

Në përfundim të vlerësimit të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe shqyrtimit të shpjegimeve e provave të paraqitura nga subjekti, Komisioni konkludon se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklarin e pasurisë së tij ndër vite.
- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me burimin e pasurisë në deklaratën “Vetting”.

- Subjekti i rivlerësimit, me veprimet e tij, me kryerjen e një ndërtimi të paligjshëm në vitin 2013, kur në të njëjtën kohë, për të njëjtin veprim ka mbajtur qëndrim tjetër në pozicionin e gjyqtarit, ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia.
- Subjekti i rivlerësimit nuk arrin të justifikojë me të ardhura shpenzimet e kryera prej tij në vitet 2009, 2011, 2012, 2013, 2014.

VI. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. (***) prot., datë 02.11.2017 për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të këtij raporti, konstatohet përshtatshmëria e subjektit, por theksohet fakti se ky raport është hartuar në mungesë të informacionit nga një prej organeve ligjzbatuese. Pas ardhjes së këtij informacioni, me kërkesë të Komisionit nr. (***) prot., datë 01.02.2018, DSIK ka rishikuar raportin për subjektin Admir Belishta. Pas rishikimit, DSIK-ja ka dërguar raportin me shkresën nr. (***) prot., datë 07.02.2018, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. (***) prot., datë 25.04.2018.

Në përfundim të procedurave të kryera nga grupi i punës për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Admir Belishta, me detyrë gjyqtar (Kryetar) në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Korçë, DSIK-ja konkludon në papërshtatshmëri të subjektit për vijimin e ushtrimit të detyrës.

Me shkresën nr. (***) prot., datë 29.10.2018, DSIK-ja ka rishikuar raportin për këtë subjekt, duke pasqyruar në të informacionin shtesë të ardhur nga agjensitë ligjzbatuese. Ky raport është deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. (***), datë 30.10.2018. Në përfundim të këtij raporti rikonfirmohet papërshtatshmëria për vazhdimin e detyrës të subjektit Admir A. Belishta.

Komisioni hetoi gjerësisht mbi faktet dhe rrethanat e parashtruara në këtë raport.

Pas informacionit shtesë të ardhur nga autoritetet verifikuese, ***** për përfshirje në veprimtari të kundraligjshme të shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit dhe atë të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm kundrejt përfitimit monetar të subjektit të rivlerësimit A. Belishta, rezulton se:

- Subjekti i rivlerësimit ***** dyshohet se ***** mund të kenë fyer dhe kërcënuar gjyqtarin M. D. pasi ky i fundit kishte rrëzuar kërkesën *****.
- ***** dyshohet se subjekti i rivlerësimit mund të ketë favorizuar një shtetas të mitur, i gjykuar për veprën penale të vrasjes.
- ***** dyshohet se A.Belishta mund t'i ketë kërkuar një shumë të konsiderueshme parash një shtetasi ***** , për të cilin mund t'i ketë kërkuar një shumë të konsiderueshme parash një shtetasi ***** , për të cilin ka pasur një proces gjyqësor për shpërdorim të detyrës dhe favorizim të kontrabandës.

- ***** , dyshohet se mund të ketë favorizuar një shtetas, i gjykuar në atë periudhë për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje.

Raporti i grupit të punës së DSIK-së (informacioni që përmbante) iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, për të krijuar bindjen në vërtetësinë e informacionit të ardhur nga agjensitë ligjzbatuese. Ky hetim konsistoi në verifikimin e rrethanave, përfshirë edhe atyre lehtësuese, që kishin çuar grupin e punës në konstatimin e papërshtatshmërisë së subjektit për vazhdimin e detyrës, si dhe vërtetësisë së ngjarjeve konkrete, me qëllim gjetjen e provave, për realizimin e një procesi të rregullt ligjor.

Pasi iu vu në dispozicion raporti i deklasifikuar pjesërisht, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të sqaruar pozicionin e tij.

Në lidhje me rastin e parë, subjekti ka shpjeguar se marrëdhënia e tij si titullar me gjyqtarin e ndjerë ka qenë korrekte. Pavarësisht se raporti i DSIK-së ishte pjesërisht i deklasifikuar, subjekti, nga marrëdhënia me gjyqtarin e ndjerë D. ka veçuar konfliktin e këtij të fundit me shtetasen Sh. M. Sipas subjektit, kjo shtetase, të paktën prej rreth 13 vjetësh, vazhdon nëpër procese gjyqësore në gjykatë, duke pasur vazhdimisht ankesa ndaj gjyqtarëve, përfshirë dhe subjektin, si dhe ndaj administratës gjyqësore, duke përbërë në këtë mënyrë një problem shqetësues. Për të vërtetuar problemet mendore të kësaj shtetase, subjekti ka depozituar edhe raportin psikiatrik. Në përfundim të shpjegimeve të tij, subjekti ka deklaruar se nuk ka fyer, apo për më tepër kërcënuar asnjë koleg, duke e konsideruar informacionin e ardhur nga organet ligjzbatuese si një barrë tepër të rëndë për të.

Në lidhje me rastin e dytë të cituar në raportin e DSIK-së, subjekti ka hamendësuar duke argumentuar kështu:

“Referuar treguesve statistikorë të gjykatës, rezulton se çështje penale me të pandehur të mitur për vrasje kam pasur në gjykime vetëm një të tillë, e konkretisht atë me të pandehur A. F. Rezulton se prokuroria ka kërkuar në bashkim të dënimeve për këtë të pandehur, masën maksimale 20 vjet burgim dhe se gjykata e ka dënuar në përfundim mbi të njëjtat akuza të prokurorisë, në bashkim të dënimeve me 18 vjet burgim, pa llogaritur këtu përfitimet ligjore të miturisë dhe gjykimit të shkurtuar. I pandehuri ka qenë mbrojtur me mbrojtës të caktuar kryesisht dhe se ka pasur një moshë miturie më pak se 16 vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale, ndërkohë që marzhi i dënimit ishte nga 10-20 vjet për akuzën kryesore të sjellë nga prokuroria. Ngjarja ishte zhvilluar në rrethana krejt rastësore mes bashkëfshatarëve. Gjykimi është zhvilluar me tre gjyqtarë dhe se vendimmarrja ka qenë unanime. Gjykata ka zbatuar ligjin, duke mos favorizuar askënd dhe mos pasur kontakt apo qënë në konflikt interesi me asnjë nga subjektet e këtij gjykimi. Dosja mbi rekurs ndodhet në Gjykatë të Lartë.”

Në lidhje me rastin e tretë të cituar në raportin e DSIK-së, i cili ka të bëjë me vendimmarrje gjyqësore, përsëri subjekti ka hamendësuar duke shpjeguar se:

“Referuar treguesve statistikore të gjykatës, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm kam pasur për gjykime vetëm dy çështje me të pandehur të akuzuar për veprat penale të shpërdorimit të detyrës dhe kontrabandës. Në të dyja rastet kam disponuar sipas prokurorisë, duke i deklaruar fajtorë dhe dënuar të pandehurit. Konkretisht, çështja penale që iu përkiste të pandehurve L. K. etj., ajo është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Korçë. Ndërkohë që edhe tek çështja penale që iu përkiste të pandehurve V. T. etj, gjykata ka mbështetur akuzën

e prokurorisë, duke i dënuar të gjithë të pandehurit, ku për njërin prej tyre gjykata ka vlerësuar edhe për zbutjen e masës së dënimit. Gjykimi ka përfunduar në afate optimale 1 muaj e 4 ditë. Gjatë gjykimit rezultonte se i njëjti mjet, i tipit kamion, që ishte kapur me mallra kontrabandë, ishte futur dhe shumë herë të tjera, në po këtë pikë doganore, madje në të njëjtin turn, ku përgjegjës ishte i pandehuri V. T. dhe se me përjashtim të një rasti nuk ishte zhdoganuar në asnjë rast tjetër. Ky vendim ishte bërë objekt ankimi në apel, i cili për doganierët kishte rrëzuar akuzat.

Bëj me dije faktin se në shumë raste Gjykata e Apelit Korçë nuk ka mbështetur vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e kryesisht në veprat penale të shpërdorimit të detyrës, veprat korruptive, apo ato në fushën e doganave, kur kjo shkallë i ka deklaruar fajtorë. Në lidhje me të dyja këto raste deklaroj bindjen e plotë se kam zbatuar ligjin, duke dhënë vendim të bazuar në provat e adminstruara në gjykim, me objektivitet dhe pa pasur tendencë ndaj askujt. Ky objektivitet rezultoi i qartë, referuar kohës së gjykimit dhe masave të dënimeve të dhëna, në raport me marzhet e këtyre dënimeve për veprat penale, për të cilat të pandehurit janë gjetur fajtorë. Çdo aludim tjetër mbi dënime të dhëna, për vepra sensitive për shoqërinë e konsideroj jo të drejtë. Kjo dosje ndodhet në Gjykatë të Lartë.”

Në lidhje me rastin e katërt të cituar në raportin e DSIK-së, i cili ka të bëjë po me vendimmarrje gjyqësore, subjekti përsëri ka hamendësuar duke shpjeguar se:

“Referuar treguesve statistikorë të gjykatës, kam pasur për gjykime disa çështje me të pandehur të akuzuar për plagosje të rënda të kryera me dashje. Në të gjitha rastet, në përbërje të trupave gjyqësore kemi marrë vendime unanime dhe se iu qëndroj këtyre vendimeve. Me përgjegjësi dhe bindje të plotë shprehem se kam zbatuar ligjin në interpretim të provave të paraqitura për secilën çështje. Asnjëra nga çështjet nuk më është cënuar nga gjykatat më të larta për efekt të deklarimit fajtor.

Ndërkohë që e vetmja çështje që është ndryshuar masa e dënimit nga 1 vit, në 3 vjet e 6 muaj është ajo me të pandehur B. K., e cila ka pasur të bëjë me çështje interpretative, vetëm përse i përket anës subjektive dhe jo për sa i përket deklarimit fajtor, apo pasojës së ardhur. Jo vetëm kaq, por të dyja trupat gjyqësore, pra 6 gjyqtarë në shkallë të parë kanë disponuar në të njëjtën mënyrë. Ndërkohë duhet të theksoj se viktima, shtetasi M. P. ka pasur një numër të konsiderueshëm çështjesh në këtë gjykatë, duke kontestuar dhe përfolur shumë gjyqtarë të kësaj gjykate, madje duke u acaruar shpesh herë dhe me administratën e gjykatës.”

Gjatë shpjegimeve të tij në seancën dëgjimore, subjekti ka theksuar faktin se gjatë gjithë karrierës prej më se 15 vjetësh si gjyqtar, nga të cilat rreth 12 vjet në drejtim të gjykatës ka përmbushur me përgjegjshmëri maksimale detyrat funksionale të gjyqtarit dhe kryetarit.

Pasi dëgjoi subjektin në seancë, shqyrtoi edhe shpjegimet e tij të paraqitura me shkrim për çështje gjyqësore konkrete, të cilat bazohen mbi hamendësimet e tij nisur nga të dhëna statistikore, shqyrtoi dhe vlerësoi dokumentacionin, Komisioni vlerëson se raporti i DSIK-së përmban elementët e parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016 dhe ai konsiderohet i plotë dhe i besueshëm.

- Në përfundim, Komisioni konkludon për subjektin e rivlerësimit Admir Belishta se është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar.

VII. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka përcjellë pranë Komisionit raportin nr. (***)prot., datë 31.05.2018 për analizimin e afësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Admir Belishta, referuar procesit të rivlerësimit kalimtar bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit;
- 2) 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Konstatohet se subjekti ka qenë i saktë në të gjitha të dhënat e plotësuara në formularin e vetëdeklarimit.

Subjekti i rivlerësimit ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2004, ka përfunduar programin e studimit Master Shkencor në Shkencat Penale në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 2007, si dhe titullin “Doktor” në Shkencat Penale në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në 2015.

Në periudhën tetor 2003 - prill 2007 subjekti ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Në vijim, në prill 2007 – aktualisht, ushtron funksionin e kryetarit të kësaj gjykate.

Subjekti i rivlerësimit deklaron se në mars 2004 - korrik 2012 ka qenë pedagog i jashtëm në Universitetin “Fan S. Noli” Korçë. Në periudhën mars 2012 – korrik 2012 ka qenë pedagog i jashtëm në Universitetin “(***)”, filiali Korçë. Në periudhën shkurt 2009 – aktualisht është ekspert në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës Tiranë. Në periudhën shtator 2015 – aktualisht është pedagog i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës Tiranë.

Subjekti i rivlerësimit Admir Belishta, ka kryer një numër të konsiderueshëm trajnimesh formuese të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe më gjerë.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit

8 tetor 2013- 8 tetor 2016, për gjyqtarin Admir Belishta janë paraqitur gjithsej 4 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (një ankesë në vitin 2013, një ankesë në vitin 2014, një ankesë në vitin 2015 dhe një ankesë në vitin 2016). Të 4 ankesat janë arkivuar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Admir Belishta përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

ANALIZA E AFTËSIVE TË SUBJEKTIT NGA KLD-ja

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit Admir Belishta identifikon normën ligjore të zbatueshme në funksion të zgjidhjes së çështjes gjyqësore. Ai e analizon normën penale në raport me rrethanat konkrete të mosmarrëveshjes dhe nxjerr konkluzione mbi çështjen nga zbatimi i saj.

Ai ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve penale. Merr në analizë juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, shkaqet e shuarjes së ndjekjes penale apo shkaqet formale që pengojnë shqyrtimin e çështjes, si dhe tregojnë kujdes për t'u njohur me aktet përpara se të disponojë mbi kërkesat e palëve.

Në zgjidhjen e çështjeve, u kushton rëndësi pretendimeve të palëve, përcakton faktin penal duke treguar provat që e mbështesin atë, analizon në mënyrë të plotë elementët e veprës penale dhe i kushton rëndësi të posaçme identifikimit të llojit dhe të masës së dënimit, duke përshtetur të gjithë treguesit që kanë rëndësi për çështjen. Në varësi të rrethanave të çështjes, diferencon llojet e dënimit kryesor me gjobë apo me burgim, analizon nëse është rasti për caktimin e dënimeve plotësuese, si dhe analizon nëse ka vend për caktimin e masave alternative.

Çështjet që ai ka shqyrtuar kanë qenë çështje penale dhe tregojnë njohuritë e tij të konsoliduara të përfutuara përmes përvojës në punë dhe formimit të vazhdueshëm akademik. Nga ana tjetër, ndër 3 dokumentet e përzgjedhura dhe 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 5 prej tyre. Në të 4 rastet, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Së fundmi, duhet evidentuar se ndaj gjyqtarit Admir Belishta përgjatë periudhës së rivlerësimit janë paraqitur 4 ankesa në Inspektoratin e KLD-së. Nga shqyrtimi administrativ i tyre nuk janë konstatuar të dhëna negative për veprimtarinë e tij profesionale dhe etike.

b) Arsyetimi ligjor

Vendimet gjyqësore të hartuara prej subjektit të rivlerësimit Admir Belishta janë të qarta, të plota dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare është organizuar sipas kërkesave të legjislacionit procedural penal dhe e standardizuar. Për shkak të standardizimit, ai bën pjesë të arsyetimit të vendimit edhe çështje procedurale mbi juridiksionin gjyqësor, kompetencat lëndore e tokësore dhe gjykimin e shkurtuar, ndonëse ato nuk janë kundërshtuar prej palëve dhe për më tepër, janë çështje që i përkasin praktikës konstante gjyqësore. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Gjithashtu, tek të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen pas marrjes së mendimit të palëve, me disponim të qartë, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Admir Belishta, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit dhe kyetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në dhomën penale. Ai ka deklaruar se në tre vitet e fundit 2014, 2015 dhe 2016, atij i janë caktuar gjithsej 576 çështje gjyqësore, ka përfunduar 544 çështje gjyqësore dhe ka mbartur 5 çështje gjyqësore në vitin 2017.

Nga të dhënat statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtari Admir Belishta ka përfunduar gjithsej 534 çështje gjyqësore, nga të cilat 531 çështje penale (158 kërkesa penale dhe 373 penale themeli) dhe 3 çështje civile të veçanta. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive.

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari Admir Belishta i ka kushtuar rëndësi arsyetimit të vendimeve gjyqësore, duke i arsyetuar shpejt ato dhe brenda afateve ligjore. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 5 ditë nga shpallja, për 1 ditë nga shpallja, për 3 ditë nga shpallja dhe për 4 ditë nga shpallja. Ndër 5 dosjet e vëzhguara, të gjitha vendimet janë arsyetuar brenda afatit ligjor.

Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtari Admir Belishta ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ai ka patur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal, ka respektuar afatet standarde të gjykimit të çështjeve që i janë caktuar, si dhe ka arsyetuar pa vonesa dhe brenda afateve ligjore vendimet gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Admir Belishta merr masat për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, me qëllim përfundimin në kohë të tyre. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës gjyqësore.

Në 5 çështje penale të vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 3 seanca, me 2 seanca, me 2 seanca, me 1 seancë dhe me 4 seanca. Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 12 seanca gjyqësore, nga të cilat 9 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 3 seanca joproduktive kanë qenë mungesa e aktit të përfaqësimit të mbrojtësit (1 seancë), mungesa

e gjyqtarit që merrte pjesë në një ceremoni mortore (1 seancë), njoftimi i parregullt i të pandehurit (1 seancë).

Seancat gjyqësore janë çelur përgjithësisht në orarin e planifikuar (me vonesë deri në 5 minuta), me përjashtim të 3 seancave, të cilat kanë filluar me vonesë 13-44 minuta. Në 2 prej këtyre rasteve subjekti i rivlerësimit ka relatuar shkakun e vonesës, që lidhej me pjesëmarrjen e tij në gjykime të tjera apo me paraqitjen e vonuar të palëve, ndërsa në rastin e tretë shkakun nuk është relatuar. Megjithatë, në asnjë prej këtyre 3 seancave, vonesa nuk ka shkaktuar pengesën e gjykimit.

Gjyqtari Admir Belishta e ka respektuar solemnitetin, duke zhvilluar gjykimin gjithmonë në sallë dhe duke i regjistruar audio seancat gjyqësore.

Gjyqtari Admir Belishta zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet proceduriale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin gjyqësor, kërkimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar. Në të gjitha rastet, disponon me vendime të ndërmjetme të qarta, me disponime të plota, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota.

Në dosjet penale të themelit ndodhet fashikulli i prokurorit, vendimi i subjektit të rivlerësimit për caktimin e seancës gjyqësore, aktet e njoftimit, aktet e hetimit paraprak të bashkuara me fashikullin e gjykimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, procesverbali gjyqësor, konkluzionet përfundimtare të prokurorit dhe vendimi gjyqësor.

Procesverbali i seancës gjyqësore është i plotë, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera dhe i nënshkruar rregullisht prej sekretares gjyqësore dhe gjyqtarit, konform kërkesave të neneve 345 dhe 346 të K.Pr.Penale.

Vetëm në 1 rast është konstatuar lapsus në vitin, që lidhet me datën e seancës, por ky lapsus nuk ka sjellë pasoja. Në çdo dosje është përfshirë 1 kopje e vendimit e hartuar me kompjuter dhe e nënshkruar vetëm nga gjyqtari/gjyqtarët, si dhe një kopje e vendimit e nënshkruar nga gjyqtari/gjyqtarët dhe sekretarja gjyqësore, me vulë të gjykatës. Aktet në të gjitha dosjet janë sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave proceduriale penale duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët dhe në fund është fashikulli i prokurorit. Çdo dosje gjyqësore është e inventarizuar rregullisht.

2. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjyqtari Admir Belishta ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 01.07.2001 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2004. Pas studimeve, në datën 16.09.2004 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Më pas, në datën 18.04.2007 është emëruar kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, detyrë që e mban edhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Admir Belishta. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Admir Belishta dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjorë të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Admir Belishta. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Admir Belishta nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e standardit të gjykatës së paanshme.

3. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Admir Belishta komunikon me etikë me palët në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 4 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Admir Belishta për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta, Në 4 çështje gjyqësore të vëzhguara, ai ka qënë gjyqtar i vetëm për gjykimin e çështjes dhe është konstatuar se ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale penale, duke respektuar afatet dhe duke dokumentuar rregullisht veprimet. Në një çështje tjetër, ai ka gjykuar në trup gjykues, me tre gjyqtarë, ku subjekti i rivlerësimit ka qënë kryesues dhe bashkëpunimi e shkëmbimi i njohurive apo përvojave profesionale me ta ka qënë në nivelin e duhur: asnjë seancë nuk ka dështuar, nuk ka pasur problematikë në këshillimin e marrjes së vendimeve të ndërmjetme apo përfundimtar, si dhe nuk ka pasur problematika të shkeljes së afateve.

Në 5 dosjet e vëzhguara nuk është identifikuar vonesë e pajustificuar dhe e padokumentuar në fillimin e seancave gjyqësore apo në depozitimin e dosjes me vendimin e arsyetuar në sekretari, që është një tregues i bashkëpunimit të duhur të subjektit të rivlerësimit.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Admir Belishta i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Ai ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 01.07.2001 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2004. Në vijim, ka marrë titullin Master Shkencor në Shkencat Penale, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 2007, si dhe titullin “Doktor” në Shkencat Penale në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në 2015. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjithashtu se ka qënë ekspert dhe lehtësues në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në 9 aktivitete trajnuese gjatë periudhës së rivlerësimit si dhe ka kryer një sërë trajnimesh si dhe ka qënë autor i disa shkrimesh juridike.

Referuar projektaktit të vlerësimit të Gjyqtarit Admir Belishta për periudhën 01.01.2007-31.12.2009 i përcjellë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, rezulton se për vitin 2009 ka katër vendime të cenuara të gjyqtarit Admir Belishta, si më poshtë vijon:

1. Çështja penale kundër të pandehurve R.H, AL, E.B, K.K, dhe S.M të akuzuar për veprën penale të “dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit” të parashikuar nga neni 298/3 të K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. 91, datë 10.03.2009 ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të pandehurit R.H dhe dënimin përfundimisht të tij me 7 vjet burgim e 7,000,000 lekë gjobë;
- Deklarimin fajtor të pandehurit A.L dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim dhe 6,000,000 lekë gjobë;
- Deklarimin fajtor të të pandehurit K.K dhe dënimin e tij përfundimisht me 20 muaj burgim dhe me 3,000,000 lekë gjobë;
- Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit E.B dhe lirimin e menjëhershëm të tij;
- Deklarimin fajtor të të pandehurit S.M dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim dhe 4,000,000 lekë gjobë duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit për një afat kohor prej 3 vitesh.

Mbi ankimin e prokurorit, Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr.155, datë 20.11.2009 ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit për sa u përket të pandehurve S.M, E.B dhe K.K;
- Ndryshimin e vendimit për të pandehurin R.H duke e deklaruar fajtor dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim dhe 6,000,000 lekë gjobë;
- Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit A.L;

Gjykata e Lartë me vendimin nr. 810, datë 27.10.2011 ka vendosur:

- *Mospranimin e rekursit të të pandehurve R.H, S.M dhe të prokurorit.*

Arsyeja e cenimit: Vendimi është rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit dhe provave, pasi nuk provohet fajësia për të pandehurin A.L si dhe nuk provohet që i pandehuri R.H të ketë kryer veprën në bashkëpunim, por vetëm në përcaktimin “më shumë se një herë”.

2. Çështja penale kundër të pandehurit V.E i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 298/3, 186/1, 189/2 dhe kundër të pandehurve K.C dhe A.A të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i K.penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. 192, datë 08.06.2009 ka vendosur:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit V.E dhe përfundimisht dënimin e tij me 6 vjet e 6,000,000 lekë gjobë;*
- *Deklarimin fajtor të të pandehurve K.C dhe A.A dhe dënimin e tyre me 6 muaj burgim;*

Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 25, datë 25.02.2010 ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit për të pandehurin V.E veprat penale të parashikuara nga nenet 186/1, 189/2 të K.Penal dhe ndryshimin e vendimit për pjesën tjetër, duke deklaruar fajtor të pandehurin V.E për veprën penale të parashikuar nga nenet 298/2 të K.Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim dhe 4,000,000 lekë gjobë, në bashkim të dënimeve dhe në aplikim të nenit 59 të K.Penal dënimin e tij përfundimisht me 4 vjet burgim dhe 4,000,000 lekë gjobë, duke urdhëruar pezullimin me kusht për 5 vite kohë;
- Deklarimin fajtor të të pandehurit V.A për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i K.Penal dhe dënimin e tij me 200,000 lekë gjobë;
- Prishjen e vendimit dhe pushimit të gjyqimit për të pandehurin K.C.

Mbi ankimin e të pandehurit V.E, Gjykata e Lartë më vendimin nr. 85, datë 06.03.2013 ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të gjykuarve.

Arsyeja e cenimit: Vendimi është rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit penal pasi nuk provohet që të pandehurit të kenë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

3. Çështja penale kundër të pandehurit B.K i akuzuar për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje të parashikuar nga neni 88/1 i K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. 329, datë 26.10.2009 ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit B.K për kryerjen e veprës penale të plagosjes me dashje nga pakujdesia parashikuar nga neni 91 i K.Penal dhe dënimin e tij me 1 vit, burgim.

Mbi ankimin e prokurorit Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 38, datë 26.03.2010 ka vendosur:

Prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me trup tjetër gjykues.

Arsyeja e cenimit: Vendimi është marrë në shkelje të dispozitave procedurale lidhur me momentin e ndryshimit të kualifikimit ligjor të veprës penale dhe legjitimitetit të kësaj gjykate për akuzën e ndryshuar.

4. Çështja administrativo-penale që i përket kërkuesit V.P me objekt “rivendosje në afat të së drejtës së apelit sipas nenit 147/2 i K.Pr.Penale”.

Gj.Rr.Korçë me vendimin nr. 543, datë13.11.2009 ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Mbi ankimin e kërkuarit, Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 2, datë15.01.2010 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesës.

Arsyeja e cenimit: Vendimi nuk është i bazuar në ligj, pasi nga gjykata nuk është bërë një vlerësim i drejtë i provave të administruara në gjykim.

Referuar denoncimeve të bëra nga publiku

1. Denoncim nr. (*) prot, datë19.06.2016 i bërë nga shtetasja R. K.**

Në denocimin e saj, kjo shtetase akuzon subjektin Admir Belishta për pengesë të proceseve të saj gjyqësore, me pretendimin se ky gjyqtar ndikon në këto procese, duke favorizuar palën kundërshtare. Nuk pranon kërkesa për përjashtim gjyqtari dhe vihet re një mosfunksionim i gjykatës.

Komisioni konstaton se:

- Denoncimit nuk i janë bashkangjitur prova që të provojnë pretendimet e shtetases R.K.;
- Në denoncimin e saj, kjo shtetase nuk ka dhënë asnjë referencë apo indicie në mënyrë që Komisioni të zhvillojë hetime për sa ajo ka pretenduar.

2. Denoncimi nr. (*) prot, datë 26.10.2018 i bërë nga shtetasi Z. S.**

Shtetasi Z.S. denoncon ndër të tjerë edhe subjektin Admir Belishta.

Në denoncimin e tij shtetasi Z. S. i referohet rastit të një kallëzimi që ai ka bërë në Prokurorinë e Korçës për veprën penale të vjedhjes ndaj një personi, i cili nuk identifikohet. Në kallëzimin e tij ai i referohet faktit se meqenëse merrej me aktivitet burse në Stamboll të Turqisë, lekët me të cilën ai i investonte në bursë, transportoheshin me autobusë nëpërmjet shoqërisë (***) sh.p.k me ortakë E.Ç., E. Sh., S.B. dhe R.C., ku autobusi i kësaj shoqërie që transportonte paratë e Z.S. është grabitur në një karburant të një qyteti të Greqisë nga një person i paidentifikuar. Shtetasi Z.S. dyshon se kjo vjedhje ka qenë e inskenuar nga ortakët e shoqërisë të përmendur më sipër, të cilët i kanë përfituar këto para. Për këtë ai ka bërë kallëzim në Prokurori, duke ia parashtruar të gjitha dyshimet dhe për këta persona. Nga ana e Prokurorisë janë konstatuar zvarritje procesi dhe në fund kjo prokurori ka vendosur pezullimin e hetimeve pasi nuk identifikohet autori.

Në lidhje me subjektin Admir Belishta, shtetasi Z. S. ngre pretendimin se subjekti me cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Korçë ka ndikuar tek Prokurori i Rrethit dhe tek prokurori i çështjes që ta mbyllë atë, pasi me një nga ortakët e shoqërisë së transportit, shtetasin E. Sh., ka lidhje faresfisnore nëpërmjet bashkëshortes së tij, dhe në këto kushte do të ishte në konflikt interesi.

Komisioni pasi bëri hetimet e tij konstatoi se:

- Lidhja faresfisnore e subjektit me E. Sh., pretenduar nga denoncuesi, nuk rezultoi e vërtetë.

- Pas verifikimit në faqen zyrtare www.gjykata.gov.al tek faqja e Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë rezultoi se E. Sh. ka pasur një proces gjyqësor pranë kësaj gjykate një çështje civile ku ai ka qenë si palë paditëse dhe kjo çështje është gjykuar nga një gjyqtar tjetër dhe jo nga Admir Belishta. Pra, nuk provohet konflikti i interesit i pretenduar. Komisioni nuk arriti të provojë ndikimin e subjektit tek prokurori i çështjes, sipas denoncimit.

3. Denoncim nr. (*) prot, datë 04.10.2018 i bërë nga shtetasi R. D.**

Në denoncimin e tij ky shtetas denoncon subjektin Admir Belishta për marrje vendimi të padrejtë në lidhje me tre raste të kërkesës për dorëheqje nga gjyqtarë të ndryshëm. Denoncuesi ka dhënë detaje për të tre rastet. Pasi iu kalua barra e provës subjektit, ai ka shpjeguar në mënyrë të detajuar pozicionimin e tij, duke sqaruar se kushtet dhe rrethanat faktike nuk kanë qenë të njëjta në të tre rastet, e për pasojë dhe disponimet e tyre kanë qenë sipas rasteve konkretë. Po kështu, të gjitha vendimet kanë qenë të arsyetuara dhe të argumentuara, të cilat i ka bashkëngjitur si prova të këtyre shpjegimeve. Ndërkohë që disponimet në lidhje me këto kërkesa mund të shqyrtohen së bashku me vendimin e themelit nga gjykatat më të larta, e që në asnjë rast nuk janë konsideruar prej këtyre gjykatave si vendime jo të drejta.

Pasi e dëgjoi shpjegimin e tij edhe në seancë, Komisioni konkludon se denoncimi i R. D nuk është i bazuar në prova dhe në fakte të besueshme.

Bazuar në pikën 4, të nenit 41, të ligjit 84/2016, Komisioni shtriu hetimin edhe mbi disa dosje gjyqësore të shqyrtuara nga ana e subjektit, sipas informacioneve që disponohen për etikën dhe aftësitë profesionale.

1. Në lidhje me çështjen penale me të pandehur A. F. i dënuar për veprën penale “Vrasje me dashje” dhe “kanosje” çështje e gjykuar nga Gjykata e Rrethit Korçë.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë e Komisionit nr. (***) prot, datë 05.11.2018 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku i ka kërkuar kopje të dosjes gjyqësore me të pandehur A. F. sipas vendimit nr. (***), datë 04.02.2016 si dhe kopje të librit të protokollit ku pasqyrohet data e depozitimit të ankimit nga ana e Prokurorisë së Rrethit Korçë;
- Shkresë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nr. (***) prot., datë 12.11.2018 drejtuar Komisionit ka konfirmuar se dosja në fjalë ndodhet në Gjykatën e Apelit Korçë si dhe ka vënë në dispozicion kopje të regjistrit të ankimit të depozituar nga Prokuroria e Rrethit Korçë;
- Shkresë e Komisionit nr. (***) prot., datë 05.11.2018 drejtuar Prokurorisë së Rrethit Korçë për të vënë në dispozicion kopje të fletës së regjistrit të depozitimit të ankimit të prokurorisë në gjykatën e Korçës;
- Shkresë e Prokurorisë së Rrethit Korçë me nr. (***) prot, datë 13.11.2018 drejtuar Komisionit;

- Shkresë e Komisionit nr. (***) prot., datë 06.11.2018 drejtuar Gjykatës së Lartë ku i kërkohet kopje e dosjes me të pandehur A. F.;
- Shkresë e Gjykatës se Lartë nr. (***), datë 12.11.2018 drejtuar Komisionit ku i vë në dispozicion kopje të dosjes më të pandehurin A.F.

Duke analizuar dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me trup gjykues A. Belishta kryesues (E.M . dhe M.K. anëtarë) me vendimin nr(***), datë 04.02.2016 ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit A. F.për kryerjen e veprës penale të “vrasjes me dashje” dhe në bazë të nenit 76 dhe 51 të K.Penal të dënohet me 9 vjet burgim;
- Deklarimin fajtor të të pandehurit A.Feçanji për kryerjen e veprës penale “të kanosjes” dhe në bazë të nenit 84 dhe 51 të K.Penal të dënohet me 6 muaj burgim;
- Në aplikimi të dy dënimeve në aplikim të nenit 55 të K.Penal dënohet me dënim përfundimtar prej 9 vjet burgim;
- Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale të pandehuri A. F. i zbritet 1/3 dënimit duke u dënuar përfundimisht me 6 vjet burgim.

Ky vendim është kundërshtuar nga Prokuroria e Korçës si dhe nga të afërmit të viktimës pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

Kjo dosje është dërguar nga ana e kancelarit të Gjykatës së Rrethit Korçë për në Gjykatën e Apelit Korçë me shkresën nr. (***)prot., datë 27.04.2016.

Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 225, datë 10.11.2016, ka vendosur “Mospranimin e ankimit të paraqitur nga Prokuroria Korçë si jashtë afatit ligjor dhe të shtetasit M. K. si ankim i bërë nga një person i palegjitimuar”.

Komisioni, nisur nga vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë, i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Korçë duke kërkuar kopje të regjistrit ku pasqyrohet depozitimi i ankimit të prokurorisë për këtë vendim.

Prokuroria e Rrethit Korçë me shkresën përcjellëse ka konfirmuar se pas kontrollit në librin e protokollit të Prokurorisë së Rrethit Korçë, nuk rezultoi i pasqyruar ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në lidhje me dosjen nr. (***) të vitit 2015, në ngarkim të të pandehurit A. F.

Komisioni i kërkoi edhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë kopje të regjistrit ku të rezultojë i pasqyruar depozitimi i ankimit të Prokurorisë Korçë.

Kjo Gjykatë i vuri në dispozicion Komisionit kopje të fletës së regjistrit të regjistrimit të ankimeve, si dhe tri korrespondenca me Gjykatën e Apelit për këtë çështje.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me shkresën nr. (***)prot, datë 19.09.2016, drejtuar Gjykatës së Apelit Korçë informon se është **depozituar ankimi nga ana e Prokurorisë në datë 12.06.2016** si dhe nga ana e familjarëve të viktimës në datë 18.03.2016 dhe se kjo Gjykatë ka kryer njoftimet e nevojshme për të dy ankimet (përgjigje e kthyer nga kryetari A.Belishta).

Gjykata e Apelit, ka rikëruar informacionin, duke qenë se përgjigja e Gjykatës së Rrethit nuk jepte të dhënat e kërkuara, dhe veç kësaj e pasqyron ankimin e prokurorisë të paraqitur në datë 12.06.2016, që është datë shumë e vonshme referuar datës së vendimit objekt ankimi (vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë 04.02.2016).

Me shkresën nr(***)prot, datë 06.10.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë i ka kthyer përsëri përgjigje Gjykatës së Apelit Korçë, duke vënë në dijeni këtë herë se ky ankim është depozituar pranë kësaj Gjykate më datë 12.02.2016, por për shkak të një ngatërrese në sekretarinë e gjykatës, për të cilën u është tërhequr vëmendja personave përgjegjës, ankimi nuk ka marrë numër rendor në vijimësi, por është vendosur me fraksion, siç pasqyrohet edhe në librin e depozitimit të ankimeve kopje, të cilën e kanë bashkëlidhur.

Nga kopja e librit të regjistrimit të ankimeve të vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë rezulton se ky ankim është i regjistruar në një rresht me numër (***) , por që nuk ka lidhje me numrin rendor që ka shënimin për ankimin me numër rendor (***) . Nga dosja e dërguar pranë Komisionit nga Gjykata e Lartë, janë evidentuar shkresat përkatëse, ajo përcjellëse e depozitimit të dosjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë për në Gjykatën e Apelit Korçë, dëftesa komunikimi të ankimeve të bëra nga Prokuroria e Rrethit Korçë dhe nga familjari i viktimës, ankimimi i familjarit të viktimës, ankimi i prokurorisë me shkresë përcjellëse etj.

Gjithashtu në këtë dosje janë të depozituara dhe shkresat e korrespondencës midis Gjykatës së Apelit Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë të sipërpërmendura, por ndodhet dhe shkresa nr. (***) prot, datë 14.09.2016 që Gjykata e Apelit ia ka drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku e njofton se nga përfaqësuesi i palës së pandehur, në seancën e datë 13.09.2016, u ngrit pretendimi se ankimet e Prokurorisë dhe familjarit të viktimës janë depozituar jashtë afatit dhe për këtë arsye kërkohet nga kjo gjykatë komunikimi me Prokurorinë për vendimin penal dhe nëse ky vendim ka marrë formë të prerë.

Në këtë dosje ndodhet e depozituar dhe shkresa e datë 16.02.2016 e Prokurorisë së Rrethit Korçë, urdhri nr. 97 për ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe caktimin e të dënuarit A.Feçanji të vuajë dënimin në IEVP D.

Në këtë urdhër citohet nga ana prokurorit që ka lëshuar këtë urdhër, në një paragraf të tij se, *“vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë në datën 15.02.2016 dhe është i ekzekutueshëm...”*

Gjithashtu në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë i depozituar në këtë dosje në fund të tij rezulton vula e vendosur nga sekretaria dhe kancelari i kësaj gjykate me shënimin **“vendimi mori formë të prerë në datë 15.02.2016, Korçë, më datë 16.02.2016”**

Gjykata e Apelit Korçë në vendimin e saj të datës 225, datë10.11.2016 ka vendosur:

“Mospranimin e ankimit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Korçë si jashtë afatit ligjor dhe të shtetasit M. K. si të bërë nga person i palegjitimuar ndaj vendimit nr. 58, datë04.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Korçë.”

Në këtë vendim Gjykata e Apelit Korçë ka argumentuar se: “Duke iu referuar këtyre të dhënave, Gjykata e Apelit krijon bindjen se ankimi i prokurorisë pavarësisht dërgimit të tij nga ana e këtij institucioni në datë 12.02.2016, nuk është regjistruar në Gjykatën e Rrethit

Korçë as në datën e paraqitjes së tij, dhe as deri në datën 16.02.2016 kur vendimi për të pandehurin A. F. është lëshuar nga kancelaria e gjykatës me shënimin se ka marrë formë të prerë (datë 15.02.2016).

Fakti që vendimi ka marrë formë të prerë dhe nuk është ushtruar ankimi nga ana e Prokurorisë është verifikuar dhe nga prokurori i ekzekutimit të vendimeve penale në momentin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit nr. 97 bashkangjitur të cilit ndodhet kopja e vendimit të gjykatës me shënimin “ka marrë formë të prerë”.

Veprimet e mëvonshme procedurale të komunikimit të ankimit, i cili është kryer në datën 22.04.2016, shumë më vonë si nga data e dorëzimit të ankimit nga ana e prokurorit, ashtu dhe shumë kohë pas kalimit të afatit 10-ditor që parashikon neni 419 i K.Pr.Penale për dërgimin e akteve të procedimit dhe ankimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor në Gjykatën e Apelit, nuk mund të konsiderohen si të kryera brenda afateve ligjore për paraqitjen e ankimit, qoftë dhe duke pasur justifikim veprime të gabuara dhe ngatërresë të gjykatës dhe në këto rrethana, duke e konsideruar si jashtë afatit ligjor, ankimi i prokurorisë nuk mund të pranohet.”

Pas hetimit të kryer, Komisioni konstatoi se duket sikur gjenden veprime fiktive në dosjen penale nr. (***) , të vitit 2015 në ngarkim të të pandehurit A.F. Për këtë, subjektit iu kalua barra e provës.

Në shpjegimet e tij, ai ka sqaruar se:

“Në lidhje me cilësinë e gjyqtarit kam dhënë shpjegime edhe tek pjesa e integritetit, ku në unison të tre kolegët kemi disponuar mbi akuzat e prokurorisë. Në lidhje me cilësinë e kryetarit jap këto shpjegime në lidhje me çështjen: nga informacionet që kam marrë nga sektori përkatës i administratës, pas konstatimit të kësaj problematike nga Gjykata e Apelit Korçë, jam vënë në dijeni se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, por si rezultat i një gabimi njerëzor ai nuk është pasqyruar në regjistrin e posaçëm fillimisht, pasi ka qënë ngatërruar me shkresa të tjera administrative, duke u shënuar me fraksion më pas, në datën e paraqitjes së tij. Pasi janë kryer njoftimet dosja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Apelit Korçë. Mbi informacionet e kërkuara nga kjo gjykatë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka kthyer përgjigjet përkatëse, të cilat kanë qënë në kohezion të gjithë atij gabimi njerëzor administrativ që ka ndodhur në atë rast.

Pra, gjykata e në këtë rast unë si titullar, kemi qënë të impenjuar maksimalisht që kjo çështje të shqyrtohej, duke iu shpjeguar arsyet e këtij gabimi. Nga ana tjetër, kryesekretarja e gjykatës, e cila ishte personi që kishte për detyrë administrimin e ankimeve dhe kryerjen e veprimeve të mëtejshme administrative, në lidhje me këtë shkelje administrative i është tërhequr vëmendja dhe se më vonë ka shkëputur marrëdhëniet me gjykatën.”

Pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura me shkrim nga subjekti, si dhe e dëgjoi atë në seancën dëgjimore, Komisioni konkludon se, pavarësisht pretendimit të tij për një gabim njerëzor, të bërë nga kryesekretarja, me cilësinë e kryetarit të kësaj gjykate, zoti Belishta ka patur detyrimin ligjor të kujdeset për mbarëvajtjen e institucionit, si dhe respektimin e afateve. Subjekti ka pretenduar për impenjim maksimal, pa dokumentuar asnjë element të këtij impenjimi. Tërheqja e vërejtjes ndaj kryesekretares nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme për të zbuluar të vërtetën dhe riparuar gjendjen e krijuar pa sjellë pasojë.

Me cilësinë e kryetarit të kësaj gjykate, subjekti do të duhej të kishte marrë masa konkrete duke referuar rastin në organin kompetent për të vërtetuar nëse ishte rasti i një gabimi njerëzor apo falsifikimi të fletës së regjistrit. Ndërhyrja në regjistrin e depozitimit të ankimeve të kësaj gjykate nuk mund të vlerësohet në mënyrë individuale nga kryetari i gjykatës, pa zbuluar arsyet dhe ndëshkuar fajtorët. Me veprimet/mosveprimet e tij, me cilësinë e kryetarit të gjykatës, subjekti ka treguar mungesë aftësisht në administrimin e institucionit që ka drejtuar. Arsyetimi i tij për një gabim njerëzor nuk ka arritur të bindë as Gjykatën e Apelit Korçë, e cila ka rrëzuar kërkesën e prokurorisë, si të paraqitur jashtë afatit ligjor. Në këtë mënyrë, organi i akuzës ka humbur të drejtën kushtetuese të ankimit.

2. Në lidhje me çështjen gjyqësore me të pandehur L. K. i dënuar për veprën penale “të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, e kryer në bashkëpunim i dënuar me 6 vjet e 8 muaj burgim.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë e Komisionit nr. (***) prot, datë 15.11.2018 drejtuar Gjykatës së Apelit Korçë ku i kërkon kopje të vendimit nr. 29, datë 06.03.2018 të Gjykatës së Apelit Korçë.
- Shkresë e Gjykatës së Apelit Korçë nr. (***) prot, datë 19.11.2018 drejtuar Komisionit ka bashkëngjitur vendimin e kërkuar.

Duke analizuar dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet:

Nga ana e të pandehurit L. K. i dënuar për veprën penale “të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, e kryer në bashkëpunim me 6 vjet e 8 muaj burgim është paraqitur përpara Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë kërkesa “Lirim me kusht”. Në gjykim i pandehuri asistohet dhe nga përfaqësues të Prokurorisë së Rrethit Korçë dhe IEVP-së Korçë.

Gjykata e Rrethit Korçë me vendimin nr. (***) i datës 15.11.2017 ka vendosur: “*Pranimin e kërkesës së të dënuarit L. K. me objekt lirim me kusht*”.

Gjykata e Rrethit Korçë në dhënien e këtij vendimi ka arsyetuar se i dënuari L. K. ka arsye të veçanta të cilat përlligjin kërkesën e tij për lirim me kusht:

- 1. Kërkuesi ka plotësuar kriterin ligjor me vuajtjen e dënimit me $\frac{3}{4}$ të dënimit të dhënë prej 6 vjet e 8 muaj burgim pasi deri ditën e dhënies së vendimit ai ka vuajtur efektivisht 5 vjet, 1 muaj e 8 ditë burgim he i kanë mbetur pa vuajtur 1 vit 6 muaj dhe 23 ditë burgim.*
- 2. Nuk rezulton të jetë dënuar më parë për krime të kryera me dashje;*
- 3. Ka arsye të veçanta që përlligjin kërkesën e tij pasi ndodhet në një situatë familjare të vështirë ku ka humbur babain, xhaxhain dhe familjet kanë nevojë për ndihmë dhe kujdesje nga i dënuari;*
- 4. Treguesit e sjelljes të të dënuarit janë pozitive dhe tregojnë se me dënimin e vuajtur është arritur plotësisht qëllimi për edukimin e tij pavarësisht faktit se është ndëshkuar me tre masa disiplinore, por këto nuk janë kryer dy vitet e fundi, pra, janë parashkuar.*

Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 29, datë 06.03.2018 ka vendosur:

*“Ndryshimin e vendimit nr. (***) prot, datë 15.11.2017 të Gj.Rr.Korçë dhe rrëzimin e kërkesës së të dënuarit L.K. për lirimin me kusht si të pabazuar në prova e në ligj.”*

Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit Korçë, ndër të tjera, shprehet për arsyet e veçanta që janë marrë në konsideratë dhe pranuar nga Gjykata e Rrethit Korçë dhe që përlligjin kërkesën e lirimit me kusht: *“...nuk rezulton se i dënuari të ketë përgjegjësi të tjera ndaj personave të paaftë, të mitur, të pazotë për t’u kujdesur personalisht....[...]. Edhe pse ajo (e ëma e të dënuarit) ka probleme shëndetësore, nuk rezulton që sëmundja “e nervit shiatik” ta bëjë atë të pamundur për t’u kujdesur për veten apo të kërkojë ndihmë nga i dënuari. Këto janë situata që nuk mund të prevalojnë mbi kriteret ligjore të parashikuara nga neni 64 i K.Penal dhe mbi këto nuk mund të nxirret konkluzion vetëm nga pohimet e të dënuarit.”*

Gjykata e Apelit Korçë ka çmuar se tre masat disiplinore si dhe dy vlerësimet negative të sjelljes së të dënuarit, duhet të vlerësoheshin nga Gjykata e Shkallës së Parë si kriter pengues për aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal, pasi në vlerësimin në tërësi të sjelljes, me qëllim ushtrimin e të drejtës për lirimin me kusht, objekt i vlerësimit nuk është vetëm periudha për dy vitet e fundit, por e gjithë periudha e vuajtur e dënimit deri në momentin e paraqitjes së kërkesës. Gjithashtu kjo gjykatë ka vlerësuar se: *“... në rastin konkret, nuk ka vend instituti i parashkrimit të masave disiplinore”*.

Nga ana e Komisionit u konstatua se:

Në argumentat e përdorur në vendimin e dhënë prej tij, duket sikur subjekti i rivlerësimit ka favorizuar të dënuarin L. K., duke interpretuar faktet dhe rrethanat në favor të të dënuarit për të lehtësuar gjendjen e tij, duke i miratuar kërkesën e lirimit me kusht.

Në lidhje me këtë rezultat të hetimit administrativ, subjektit iu kalua barra e provës, për të sqaruar pozicionin e tij. Ai mbajti të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e paraqitura me shkrim, ashtu edhe deklarimin e tij në seancën dëgjimore.

Për këtë subjekti ka deklaruar se:

“Ky shtetas, në cilësinë e të dënuarit, i është drejtuar gjykatës me një kërkesë ku kërkonte lirimin e tij me kusht për pjesën e mbetur të dënimit. Gjykata në përfundim të gjykimit kishte disponuar me pranimin e kësaj kërkesë, duke vlerësuar se referuar kriteret ligjore dhe provave të administruara kërkesa paraqitej e bazuar. Në vendimin gjyqësor gjykata ka arsyetuar në mënyrë të hollësishme arsyet ligjore që e kanë çuar në marrjen e këtij vendimi gjyqësor, duke analizuar në mënyrë të detajuar kriteret ligjore të nenit 64 të K. Penal, të ballafaquara me situatën e rasti konkret. Rezulton gjithashtu se aktorët e këtij gjykimi, përjashtuar përfaqësuesin e prokurorisë, si vetë kërkuesi, institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale, i cili mbikëqyrte të dënuarin në mënyrë të përditshme, si dhe shërbimi i provës kishin shprehur dakordësinë për pranimin e kësaj kërkesë. Ndërkohë prokurori në ankimin e tij kontestonte vendimin me arsyetimin se nuk ishin provuar arsyet e veçanta apo nuk ishin interpretuar saktë elementët e sjelljes. Nga ana tjetër rezultonte se qëndrimi ndryshe i mbajtur nga Gjykata e Apelit në këtë rast nuk kishte të bënte me aspekte procedurale, por me vlerësimin ndryshe të provave, e cila kishte kompetencë funksionale si një gjykatë më e lartë dhe që vetë ligji e parashikon. Pavarësisht vendimit të kësaj gjykate, të cilin e respektoj, mendoj që arsyetimi dhe argumentet e vendimit të shkallës së parë të disponuar prej meje, janë ligjore. Vendimi paraqitet i arsyetuar sipas kërkesave ligjore dhe i argumentuar.”

Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura me shkrim, konkludon se subjekti nuk ka interpretuar dhe argumentuar në mënyrë korrekte rrethanat dhe faktet konkrete të çështjes. Ai nuk ka respektuar kriteret e përcaktuara qartësisht nga neni 64 i Kodit Penal ose/dhe ka bërë interpretim të gabuar të tyre. Gjithashtu nga ana e subjektit, me cilësinë e gjyqtarit, nuk është marrë parasysh si provë në të gjithë tërësinë e tij, raporti i paraqitur përse i përket masave disiplinore nga IEVP-ja Korçë, por vetëm është cituar pjesa që lehtëson të dënuarin.

Arsyetimi i subjektit bie ndesh edhe me vendimin unifikues nr. 2, datë 25.05.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Shpjegimet e subjektit nuk arrijnë të krijojnë bindjen tek Komisioni se arsyetimi i vendimit ka qenë i plotë, bazuar në prova dhe fakte. Mosmarrja parasysh e provave, keqinterpretimi i kriterëve të përcaktuar qartësisht në dispozitat ligjore penale e kanë çuar gjykatën në marrjen e një vendimi, që është rrëzuar nga gjykata e shkallës më të lartë. Komisioni vlerëson se subjekti e ka favorizuar të dënuarin, duke interpretuar faktet dhe rrethanat me qëllim lehtësimin e pozitës së tij.

3. Në lidhje me çështjen gjyqësore me të pandehur K. B., V. T., M. Z. dhe D. B. të dënuar për veprën penale “kontrabandës me mallra të tjera” dhe tre të tjerët të veprës penale të “shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim”.

Hetimi i kryer nga Komisioni:

- Shkresë e Komisionit nr. (***) prot., datë 06.11.2018 drejtuar Gjykatës së Lartë për të vënë në dispozicion kopje të dosjes gjyqësore;
- Shkresë e Gjykatës së Lartë nr. (***) prot., datë 12.11.2018 drejtuar Komisionit ku përcillet dosja e kërkuar.

Analiza e bërë nga shqyrtimi i dokumentacionit

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. (*), datë 20.03.2017 ka vendosur:**

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit K. B. për veprën penale “Kontrabanda me mallra të tjerë” dhe dënimin e tij me 1 vit e 6 muaj burgim. Në aplikim të 1/3 së dënimit dënimin përfundimtar të K. B. me 8 muaj burgim.*
- *Deklarimin fajtor të V.T. për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” e kryer në bashkëpunim dhe dënimin e tij me 1 vit e 6 muaj burgim. Në aplikim të 1/3 dënimit përfundimtar me 1 vit burgim. Të pandehurit V. T. i caktohet një dënim plotësues duke iu hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve publike për 1 vit.*
- *Deklarimin fajtor të M. Z. për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” e kryer në bashkëpunim dhe dënimin e tij me 1 vit burgim. Në aplikim të 1/3 dënimit përfundimtar me 8 muaj burgim. Të pandehurit M. Z. i caktohet një dënim plotësues duke iu hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve publike për 1 vit.*
- *Deklarimin fajtor të D. B. për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” e kryer në bashkëpunim dhe dënimin e tij me 1 vit burgim. Në aplikim të 1/3 dënimit përfundimtar me 8 muaj burgim. Të pandehurit D. B. i caktohet një dënim plotësues duke iu hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve publike për 1 vit.*

Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim K. B. i cili nuk ka qenë dakord me këtë vendim si vendim i padrejtë dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Po kështu ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim dhe të pandehurit V. T., M. Z. dhe D. B., pasi ky vendim është marrë duke çmuar gabim provat në gjykim.

Gjykata e Apelit Korçë me vendimin nr. 236, datë 24.07.2017 me vendimin e saj ka vendosur të lërë në fuqi vendimin për K.B., si vendim të bazuar në prova dhe në ligj, dhe ka prishur vendimin për V. T., M. Z. dhe D. B.

Në vendimin e saj Gjykata e Apelit Korçë është shprehur se: *“Për sa i përket akuzës për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 i K.Penal për të pandehurit V.T., M. Z. e D. B., Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi është marrë në kundërshtim me ligjin dhe provat e ndodhura në fashikullin hetimor dhe në këto rrethana ai duhet të priset duke u pushuar gjykimi i çështjes penale në ngarkim të këtyre të pandehurve.”*

Kjo gjykatë ka argumentuar se: *“Gjykata e Shkallës së Parë Korçë, pavarësisht se në vendimin e saj përmend shumë herë faktin e shkeljes së detyrimeve që duhet të kryenin për përmbushjen e rregullt të detyrës prej tyre në asnjë moment nuk ka përcaktuar se kush është detyra konkrete që është shkelur nga secili prej të pandehurve në rastin konkret dhe kush është lidhja shkakësore e saj me pasojën e ardhur, që është shmangia e detyrimit doganor nga ana e të pandehurit K. B. [...] Përsa i përket pranimit të Gjykatës për heshtjen e të tre të pandehurve për të njoftuar organet policore, ai mund të konsiderohet vetëm një hamendësim i pabazuar në prova dhe duke qenë i dyshimtë nuk mund të përdoret kundër të pandehurve. [...] Të pabazuara dhe në kundërshtim me ligjin janë dhe pranimet që i bën Gjykata indicieve rastësore, të cilave ju jep vlerën e provës të pakundërshtueshme në vendimin e saj. [...] I papranueshëm është dhe arsyetimi tjetër i Gjykatës se të katër të pandehurit shfrytëzuan momentin kur punonjësit e antikntrabandës ishin larguar nga ambientet e doganës për të ngrënë bukë. Kjo rrethanë nuk ka lidhje me çështjen dhe për më tepër ngarkon me përgjegjësi administrative punonjësit e anti kntrabandës të cilët kanë braktisur vendin e punës. [...] Mungojnë elementët e anës objektive të veprës penale pasi nuk ka asnjë mosveprim me dashje nga ana e të pandehurve në ushtrimin e detyrës së tyre, mosveprim që ka sjellë cenimin e interesave të shtetit siç arsyeton Gjykata e Shkallës së Parë.”*

Nga ana e Komisionit u konstatua se arsyetimi i këtij vendimi gjyqësor nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk është i plotë, pasi nuk referohet mbi provat dhe faktet, por është bazuar në hamendësime. Në këtë arsyetim nuk është bërë një analizë e thelluar e provave, duke sjellë edhe cenimin e këtij vendimi nga Gjykata e Apelit.

Subjektit iu kalua barra e provës, për të sqaruara pozicionin e tij në lidhje me këtë konstatim të Komisionit.

Në shpjegimet e tij me shkrim dhe në seancën dëgjimore, ai pretendoi se:

“Për këtë dua të sqaroj se dënimi i të katër të pandehurve, njëri për kntrabandë dhe tre të tjerët, të cilët ishin doganierë për shpërdorim detyre është bërë mbi prova, të cilat provonin tej çdo lloj dyshimi të arsyeshëm, jo vetëm ekzistencën e veprave, por dhe autorësinë. Gjykimi ndaj tyre është zhvilluar i shkurtuar dhe ka përfunduar për 1 muaj e 4

ditë. Gjykata ka vlerësuar se prokuroria kishte konkluduar drejt për deklarimet fajtorë, llojet e dënimeve, si dhe për masat e dënimeve, përjashtuar të pandehurin V. T. për të cilin gjykata e kishte zbutur këtë dënim me 4 muaj burgim. Kjo çështje rezultonte e hetuar në dinamikë dhe se mjete që posedohej nga i pandehuri B. hynte dhe dilte në doganë plot 12 raste dhe nuk kryente asnjë zhdoganim, me përjashtim të njërit rast si dhe këtij të fundit ku është kapur me mall kontrabandë. Për “koinçidencë” mjete futej e dilte në turnin kur ndodhej njëri prej doganierëve, shtetasi V. T., si përgjegjës turni. Po për koinçidencë edhe në rastin e fundit asnjë nga të pandehurit nuk kishin kryer detyrën funksionale të tyre, ku ky mjet kishte kaluar dhe malli kishte qënë i pazhdoganuar.

I qëndroj bindjes së krijuar, tej çdo lloj dyshimi të arsyeshëm, se vendimi bazohej në prova të pakundërshtueshme për fajësinë dhe se vlerësimi ndryshe nga Gjykata e Apelit i provave, përveç se më jep të drejtën ta respektoj vendimmarrjen e një shkalle më të lartë si jurist, nuk më jep të drejtën ta pranoj në drejtësinë e kësaj vendimmarrjeje. Një vendimmarrje që nga njëra anë pranon kryerjen e kontrabandës nga shtetasi i pandehur, por nuk pranon shpërdorimin e detyrës nga punonjësit e doganës, që nuk i kanë bërë kontroll makinës së këtij shtetasi kur ka hyrë e ka dalë disa herë, i cili ishte i tipit kamion, e që ka hyrë pikërisht në pikën doganore, ky mendoj është një qëndrim kontradiktor i Gjykatës së Apelit. I qëndroj mendimit dhe bindjes se vendimmarrja ime është e drejtë, vendimi është dhënë në përputhje me ligjin, masat e dënimeve kanë qënë brenda marzheve të dënimit, nuk janë vlerësuar se duhej që të ngriheshin mbi masat e prokurorit. Po kështu dhe dënimet plotësuese të cilat janë minimale janë dhënë në përputhje me ligjin dhe me natyrën e veprës penale të kryer.”

Pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit, Komisioni konkludon se subjekti nuk arriti të bindë me shpjegimet e tij.

4. Komisioni është vënë në dijeni në lidhje me çështjen gjyqësore me të pandehur K. H. me akuzën e veprës penale “Plagosje e rëndë me dashje”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- **Shkresë nr. (***) prot, datë 27.09.2018**, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për të vënë në dispozicion dosjen gjyqësore me nr. (***) me të pandehur K. H.

Shkresë e Gjykatës së Rrethit Korçë me nr. (*) prot, pa datë**, drejtuar Komisionit duke vënë në dispozicion dosjen e kërkuar.

Analiza e bërë në lidhje me dokumentacionin e paraqitur në dosje.

Gjykata e Rrethit Korçë (me kryetar senace A. L. dhe me anëtar A. Belishta dhe S. P.) me vendimin nr. (***) të datës 08.06.2016 ka vendosur:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit K. H. për kryerjen e veprës penale të “Plagosjes së rëndë me dashje” dhe në zbatim të nenit 88/2 të K.Penal dënimit të tij me 6 vjet burgim.*
- *Në aplikim të nenit 406/1 të K. Pr. Penale dënimit përfundimisht të tij me 4 vjet burgim;*
- *Në aplikim të nenit 59 të K.Penal, Gjykata urdhëron pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim duke e vendosur të dënuarin K. H. në provë për një afat prej 3 vjetësh me kusht që gjatë kësaj periudhe të mos kryejë veprë tjetër penale si dhe të mbajë kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës, zyra vendore Korçë.*

Për sa i përket aplikimit të nenit 59 të K.Penal për pezullimin e vendimit, gjykata ka arsyetuar se duhet pranuar, pasi plotësohen kriteret ligjore të parashikuara për këtë rast, për sa i përket ekzistencës të një sërë rrethanash të veçanta për aplikimin e kësaj alternative dënimi dhe konkretisht:

- *Rrezikshmëri e ulët e të pandehurit, i cili rezulton me gjendje gjyqësore i padënuar më parë për kryerjen e ndonjë veprë penale;*
- *Moshën e tij (i dtl.14.12.1977), kushtet familjare të të pandehurit i cili është kryefamiljar dhe ka në përbërjen familjare, dy fëmijë të mitur (vajza e datël.20.08.2007 dhe vajza tjetër e datël.24.04.2009) të cilat janë në vazhdim të procesit mësimor dhe mbajtja e izoluar e të pandehurit do të ndikonte në përkeqësimin e kushteve të mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve;*
- *Rrethanat e kryerjes së veprës penale (në grindje e sipër dhe sipas të dëmtuarit gjithçka ka ndodhur në gjaknxehtësi e sipër);*
- *Sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale duke pranuar akuzën dhe shprehur pendim të thellë, si dhe normalizimin e marrëdhënieve të të dëmtuarit (referuar deklaratës noteriale përkatëse ku i dëmtuari A. H. si dhe pyetjes së tij në seancë gjyqësore, i cili ka deklaruar se ai e ka falur K. H. dhe nuk ka bërë ankim ndaj tij).*

Vendimi i gjykatës referuar shënimit të bërë nga kancelaria e gjykatës rezulton se ka marrë formë të prerë më datë 18.06.2016, pra, brenda afatit 10-ditor, çka do të thotë që nuk është ushtruar ankim ndaj këtij vendimi as nga i dëmtuari, dhe as nga Prokuroria e Rrethit Korçë.

Nga ana e Komisionit u konstatua se:

Në arsyetimin e saj, gjykata thekson rrezikshmëri të ulët të të pandehurit, i cili rezulton me gjendje gjyqësore i padënuar më parë për kryerjen e ndonjë veprë penale. Por, nisur nga dinamika e kryerjes së veprës penale, referuar deklaratimeve të të dëmtuarit dhe të pandehurit si dhe akteve të ekspertimit, vepra penale e plagosjes me dashje rezulton të jetë kryer me veprime të dhunshme dhe i ka shkaktuar të dëmtuarit pasoja të rënda, ku në rast të mosmarrjes së mjekimit dhe trajtimit të duhur mjekësor të menjëhershëm, do të kishte pasoja të rënda për jetën (akti i riekspertimit mjeko-ligjor në fq.5);

Gjithashtu në arsyetimin e vendimmarrjes, gjykata i referohet moshës së të pandehurit (dtl.14.12.1977), megjithëse rezulton se i pandehuri ka qenë 39 vjeç në kohën e dhënies së vendimit, pra, ai ishte madhor me zotësi të plotë për të vepruar si dhe i përgjegjshëm në kohën e kryerjes së veprës penale. Kjo do të thotë se moshja e subjektit nuk mund të konsiderohej si një kriter lehtësues në vlerësimin e veprës penale.

Gjithashtu, në arsyetim, gjykata ka përmendur si rrethanë lehtësuese, se vepra është kryer në gjaknxehtësi e sipër, ndërkohë që në kundërshtim me këtë fakt nga dinamika e ngjarjes së përshkruar, duket që ajo ka ndodhur me veprime pasuese, pra, nga momenti i parë i goditjes, pasuar më pas dhe me veprime të tjera, pas shkuarjes në shtëpi dhe me marrjen e armës së gjahut ku mendohet se me qytën e saj e ka goditur për herë të dytë të dëmtuarin. Komisioni konstatoi se në arsyetimin e vendimit, nga ana e gjykatës nuk është përmendur niveli arsimor i të pandehurit, pasi ky do të konsiderohej si “kriter në disfavor të të pandehurit” për arsye se nga vetë vendimi i gjykatës ai rezulton të jetë me arsim 8- vjeçar,

çka e bën të pandehurin jo të besueshëm për formim të mjaftueshëm për të kuptuar veprimet e tij, në mënyrë që të mos përsërisë në të ardhmen veprë tjetër penale, apo aftësinë e tij për integrim në shoqëri.

Subjektit iu kalua barra e provës, për të sqaruar pozicionin e tij për mënyrën e arsytimit të këtij vendimi që duket sikur është favorizues për të pandehurin, duke bërë interpretim të gabuar të dispozitave të Kodit Penal.

Në shpjegimet e tij, subjekti ka sqaruar se:

“Në këtë çështje kam qënë anëtar i trupit gjykues së bashku me gjyqtarin S.P., ku kryesues ka qënë gjyqtari A. L. Trupi gjykues pasi ka shqyrtuar dhe analizuar në dhomë këshillimi provat e administruara dhe i ka ballafaquar me kërkesat e ligjit, ka konkluduar për deklarinim fajtor të të pandehurit, për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje, duke e dënuar me 6 vjet burgim, e më pas për shkak të gjykimit të shkurtuar dënuar përfundimisht me 4 vjet burgim. Më pas, në lidhje me mënyrën e ekzekutimit të këtij vendimi gjykata në unison ka vendosur për pezullimin e vendimit me burgim për pjesën e mbetur të dënimit, duke e vënë të pandehurin në provë në një afat prej 3 vjetësh.

Rezulton se me disponimin në këtë mënyrë, si dhe me analizën e përdorur në vendim gjatë arsytimit, nga kryesuesi i seancës, është pajtuar dhe përfaqësuesja e prokurorisë, duke mos paraqitur ankim në lidhje me këtë vendim gjyqësor. Theksoj gjithashtu se argumentet e përdorura në arsytimin e vendimit përbëjnë argumenta bindëse, e në mënyrë të posaçme të analizuara në këndvështrimin e qëllimit të një dënimi penal, i cili nuk shihet thjesht dhe vetëm në aspektin ndëshkues, por edhe parandalues dhe risocializues.

Elementet ligjore shumë të rëndësishëm, që gjykata i ka kushtuar vëmendje të posaçme në këtë rast, janë ata që kanë të bëjnë me faktin e sjelljes së të pandehurit pas kryerjes së veprës penale, atë të pranimit të veprës dhe pendimit të thellë të treguar nga i pandehuri, faktin e normalizimit tërësor të marrëdhënieve midis të pandehurit dhe viktimës, të cilët ishin kushërinj të parë me njëri tjetrin, si dhe arsyet apo nevojat familjare ku rezultonte kryefamiljar me dy fëmijë të mitur, të cilët vazhdonin procesin e shkollimit, ku prania e babait ishte e domosdoshme. Po kështu nga vendimi gjyqësor, tek pjesa e gjeneraliteteve, shihet qartë fakti se i pandehuri ka pasur arsimin 8-vjeçar, ndërsa tek pjesa e administrimit të provave konstatoheshin rrethanat e zhvillimit të ngjarjes, ku fillimisht kishin qënë ato të çastit e më pas situata kishte agravuar edhe në një episod të dytë.

Të marra dhe vlerësuara në tërësinë e tyre të të gjitha elementëve faktike konkurrues në rastin konkret gjykata kishte çmuar aplikimin e nenit 59 të K. Penal, vendimmarrje siç u theksua më lart nuk ishte kontestuar nga asnjë prej subjekteve procedurale duke marrë formë të prerë vendimi pa ankim.”

Pasi shqyrtoi këto pretendime të subjektit, Komisioni konkludon se subjekti nuk arriti të krijojë bindjen për interpretim të drejtë të kriterëve ligjore të parashikuara në nenin 59 të Kodit Penal. Në mënyrë të përsëritur, Komisioni konstaton se subjekti i ka përdorur aftësitë e tij interpretative në favor të të pandehurit, pa u bazuar në fakte dhe në prova. Një gjë e tillë është konstatuar edhe nga Gjykata e Apelit në vendimin nr. (***) datë 20.03.2017 dhe vendimin nr. (***) i datës 15.11.2017, të shqyrtuara më lart, por edhe në katër vendimet e

cenuara gjatë vitit 2009, referuar projektaktit të vlerësimit për periudhën 01.01.2007-31.12.2009 i përcjellë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit profesional, pasi shqyrtoi raportin e vlerësimit profesional të hartuar nga KLD-ja, shqyrtoi denoncimet nga publiku, si dhe katër dosjet gjyqësore të kërkuara bazuar në pikën 4 të nenit 41, të ligjit 84/2016, Komisioni çmon se, përtej vlerësimit pozitiv nga KLD-ja, si institucion ndihmës, të metat e konstatuara në shqyrtimin e katër dosjeve gjyqësore reflektojnë mangësi profesionale të tilla, që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Të tilla mangësi konsiderohen mënyra jokorrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, konstatime këto edhe të gjykatave më të larta.

KONKLuzioni Përfundimtar

Pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Admir Belishta, në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konkludon se:

- subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë;
- subjekti rezultoi i papërshtatshëm në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës;

Duke kryer një vlerësim tërësor të të tri kriterëve, mbi të cilat mbështetet procesi i rivlerësimit të gjyqtarit, Komisioni konkludon, gjithashtu, se subjekti Admir Belishta, me veprimet/mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të pikës 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit e rivlerësimit, z. Admir Belishta.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 21.12.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

OLSI KOMICI
Kryesues

LULZIM HAMITAJ
Anëtar

GENTA TAFA (BUNGO)
Relatore

DENISA KOSTA
Sekretare gjyqësore